

## INTERVISTË ME CHRISTOPHER DELL

Washington D.C. | Data: 27 gusht, 2018

Kohëzgjatja: 145 minuta

Të pranishëm:

1. Christopher Dell (I intervistuari)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja/ Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Anna Di Lellio:** Në rregull, vetë fillo duke më treguar diçka për veten. Fillimisht emrin tënd, ku je lindur dhe...

**Christopher Dell:** Në rregull, emri im është Christopher Dell. U linda në New Jersey më 1956 dhe jam ende ligjërish banor i shtetit të New Jersey. Kam qenë gjatë gjithë jetës, pavarësisht karrierës në Shërbimin e Jashtëm. Ma bëj ndonjë pyetje, Anna. (qesh)

**Anna Di Lellio:** Në rregull, ku në New Jersey? A mund të më tregosh pak për prapavijën e familjes tënde? Babai yt, sa antarë, apo për familjen tënde tjetër?

**Christopher Dell:** Sigurisht, unë u linda në Hackensack që është shumë afër New York. Familja ime është prej Palisades Park, të cilën ti mund ta dish pasi që je nga New York. U rrita gjithë jetën në qytezën e quajtur Holmdel, që është afër Jersey Shore. Ti e di që po e xhirojmë këtë intervistë një ditë a dy pas vdekjes së John McCain. Pothuajse secili tregim për të fillon me atë se ka qenë i biri dhe nipi i dy admiralëve të marinës. Epo, unë jam i biri, nipi dhe vëllau i elektrikistëve. Babai im, vëllau dhe gjyshi ishin në IBW<sup>1</sup> në New York dhe sindikata më ka ndihmuar me financimin e kolegjit. E kam fituar një bursë të cilën e ka sponsorizuar sindikata për të shkuar, për të shkuar në Universitetin e Kolumbias.

Ne kemi jetuar në lagjen e parë komunale, e cila u ndërtua në vitet e '50-ta. U shpërngulëm aty 1957-tën, ka qenë prej atij eksodit të hershëm të lëvizjes prej brendësisë në drejtim të periferisë. Holmdel prej atëherë është bërë njëfarë komuniteti më me prosperitet në SHBA. Mendoj që më së shumti njerëz nga Holmdel kanë vdekur në 9/11 se sa prej ndonjë vendi tjetër në New York. Shumë prej stafit të Fitzgerald Cantor<sup>2</sup> u vendos në atë qytezë. Sigurisht, ajo ndërmarrja juridike ka pësuar humbje të tmerrshme atë ditë.

Pra unë jam rritur në një mjedis gjysmë-rural, gjysmë-periferik. Puna ime më e hershme, e para ka qenë puna në një fermë. Ka qenë një fermë që u ndërtua në shekullin XVII, aty mbrapa pronës, lagjes

<sup>1</sup> *International Brotherhood of Electrical Workers* (Vëllazëria Ndërkombëtare e Punonjësve Elektrikë) është sindikatë e punës që përfaqëson afro 750,000 punëtorë dhe pensionistë të industrisë elektrike në Shtetet e Bashkuara, Kanada, Panama, Guam, dhe disa kombe të ishullit të Karaibeve; përfaqëson veçanërisht elektrikistët, industrinë e ndërtimit dhe punonjës të tjerë të shërbimeve publike.

<sup>2</sup> Cantor Fitzgerald është një ndërmarrje amerikane e shërbimeve financiare që u themelua në vitin 1945. Selia e kësaj ndërmarrje u shkatërrua gjatë sulmit në ndërtesat e *World Trade Center*, më 11 shtator 2001

komunale ku jetonim, dhe prej klasës së pestë, dhe disa vite gjatë shkollës së mesme, unë punoja çdo verë në fermë me familjen e atij lokaliteti. Dhe ma ka dhënë një ndjenjë të madhe të vendit dhe historisë dhe njëfarë ndjenjë e përkatësisë në atë vend sepse ajo familje kanë qenë fermerë në atë vend që para Republikës, që prej fillimit të shekullit të XVIII. Për fat të keq u shtynë dhe u larguan, u ndërtuan shtëpi aty. {tregon me dorë në anën e djathtë} I ulur aty afër dritarës disa rreze nga hambari origjinal që u vendos atje nga kolonët anglezë. Ishte vendosur fillimisht nga holandezët, në këtë pjesë të shtetit, më 1666.

Pastaj, anglezët erdhën më vonë, kur u vendos ai hambar indianët [Amerikanët e parë] ende jetonin nëpër fusha rreth fermës. Shkolla e gramatikës ku shkoja quhej “Indian Hill” për shkak të kodrës ku ishte ferma, aty kishte varreza të indianëve, i shpiknin këto gjëra. Pra është një ndjenjë e mirë, gjithmonë e kujtoj që e kam një identitet të fortë prej nga vi, me New Jersey, dhe si rezultat, sigurisht me SHBA-në.

**Anna Di Lellio:** Pse nuk u bërë elektrikist?

**Christopher Dell:** Mjafton një për secilën gjeneratë (qesh). Munden, a e din, është profesion i mirë, sidomos për sindikalistët në New York. Është ende profesion shumë i mirë por, unë gjithmonë isha më i prirur për të lexuar dhe shkruar dhe gjëra të tilla, nuk mendoj që kisha dhunti për të përdorur vegla. Megjithatë babai më ka mësuar, mund t’i ndërroj të gjitha poçat elektrike {tregon pas vetes} dhe ndërprerësët e prizat, nëse të nevojitet dikush (qesh). Kam bërë rikyçjen e kablllove këtu, këto javët e fundit, në këtë shtëpi, si pjesë e përgatitjes së shtëpisë për ne (qesh).

**Anna Di Lellio:** dhe... ti ke shkuar në Kolumbia, pra ‘56, ‘76-tën, ‘75-tën?

**Christopher Dell:** Kam shkuar ‘74-tën dhe kam diplomuar ‘78-tën, po.

**Anna Di Lellio:** Pra, ke qenë mjaft i ri.

**Christopher Dell:** 18, moshë normale për universitet.

**Anna Di Lellio:** Çfarë ka qenë eksperiencia jote si student i kolegjit në Universitetin e Kolumbias?

**Christopher Dell:** Vërtetë më pëlqeu. Kolumbia në atë kohë, ka qenë disi, ishte një pikë e ulët për Kolumbian. Kjo ishte vetëm gjashtë vite pas demonstratave të studentëve dhe trazirave të ‘68-tës. Universiteti ishte dobësuar pak, fizikisht, por kualiteti i edukimit ishte ende superior. Dhe mendoj që unë si shumica e njerëzve që shkojnë në Kolumbia, jam nisur me mendimin se aspekti më i rëndësishëm është kurrikula bazë e tyre. Në vitet e ‘20-ta, mendoj që Kolumbia kishte hartuar këtë

kurrikul të ndërtuar rreth librave të më të rëndësishëm. Lexon filozofi, duke filluar me Aristotelin dhe Sokratin dhe vazhdon me Marksini dhe Leninin. Lexon letërsi, duke filluar me “Iliadën” dhe “Odisenë” dhe vazhdon më tutje. Kishte pak diversitet aty, mësimdhënësit kishin diversitet rreth asaj se çka përzgjidhnin, por mendoj se ta kanë dhënë bazën, një bazament shumë të mirë për ide më të mëdha, dhe njëfarë morali, çështje politike, filozofike që edhe sot e definojnë botën. Krahas ndryshimeve që ndodhin sot në botë, disa pyetje janë të përjetshme.

Pra kjo ishte e mira e Kolumbias dhe sigurisht ishte edhe ekspozimi në New York. Pasi që isha aty gjatë asaj periudhe, titulli i famshëm i gazetës, “Fordi New York-ut: Vdis<sup>3</sup>”. Pra nuk ishte as epoka e artë e New York-ut por prapë kam pasur një eksperiencë të shkëlqyeshme, ishte ende një qytet me klas botëror, edhe pse sot është shumë më me prosperitet. New York është tash pak më shumë si Disneyland, pasi që shumë njerëzit e thjeshtë po largohen për shkak të çmimit të madh të jetesës aty.

Por mua më ka pëlqyer jashtëzakonisht shumë, dhe ishte, Kolumbia ishte e mirë me mua. Ata ma dhanë një bursë për ta vazhduar shkollimin pasuniversitar, faktikisht e paguajtën Oksfordin për mua. Dhe mendoj që në shumë aspekte, kjo me të vërtetë i hapi derë karrierës sime për Shërbim të Jashtëm.

Kur ju bashkangjita Shërbimit të Jashtëm në janar të 1981-tës, Jimmy Carter ishte edhe dy javë të tjera president. Në klasë kanë qenë 52 antarë dhe në Teheran ishin 52 pengje. Ishte e qartë përse ata na punësuan, cili do të ishte funksioni ynë, nëse ata njerëz nuk do të ktheheshin në shtëpi. Fatmirësisht, janë kthyer por secili prej atyre 52 antarëve të klasës sime kanë jetuar jashtë vendit në ndonjë rast apo një tjetër. Mendoj që po të mos shkoja për studime në Angli, nuk do të hyja në Shërbimin e Jashtëm edhe pse i kam kaluar provimet dhe të gjitha ato. Ata qartësisht e kanë kërkuar dikë me përvojë ndërkombëtare si një nga kriteret e punësimit.

**Anna Di Lellio:** Pra ka qenë një kërcim i madh nga Hackensack në Oxford?

**Christopher Dell:** Paksa kërcim i madh (qesh). Po ka qenë, edhe në Angli isha kur ishte në një pike të ulët. Kishte protesta të punëtorëve, mungesë të rrymës para se të vinte Margaret Thatcher dhe të fillojë ta krijoj Britaninë moderne për çfarëdo... {lëviz dorën para fytyrës} nuk kemi nevoj të hyjmë andej, por ashtu siç mendoni që është sot. Disi fillim i një kthese ekonomike dhe shoqërore, por ishte eksperiencë e mrekullueshme. Sigurisht, më mirë është të kthehesh pasi i ke kaluar ditët si student ashtu siç do të doje nëpër kafene dhe librari, edhe pse kishte më pak librari, sigurisht.

<sup>3</sup> Në një fjalim para Klubit Kombëtar të Shtypit më 29 Tetor 1975, Presidenti Gerald Ford mohon që qyteti i New York-ut është afër falimentimit dhe refuzon ndihmën federale, duke bërë që të nesërmen *New York Daily News* ta botojë një tekst me titull famëkeq *Ford to City: Drop Dead* [Fordi qytetit: Vdis].

Ishte një eksperiencë e vështirë pasi që ishte një qasje komplet ndryshe ndaj edukimit, qasje komplet ndryshe e mësimdhënies. Dhe disi i shkonte pak për shtati amerikanit, i cili është mësuar me një qasje shumë të strukturuar, me semestër, me klasë dhe vlerësime e notime. Asnjërin prej këtyre nuk i kishe në Oxford. Gjithçka hidhej si zari në ditën e provimit përfundimtar pas dy viteve, dhe nëse nuk merrje të gjitha [notat] A [dhjetshe] ngelje në gjithë kursin. Ishte mjaft stresuese, siç mund ta imagjinosh, por eksperiencë e mirë.

Pak pas kësaj, i jam bashkëngjitur Shërbimit të Jashtëm, diku pas gjashtë muajve. Edhe pse mund t'ju bashkëngjitesha më herët, disa gjëra nuk ndryshojnë në qeverinë e SHBA edhe pse ju tregova që po largohesha nga Anglia dhe po kthehesha në New Jersey, ata dërguan letër ofertën time Mbretërisë së Bashkuar, por, sigurisht, kurrë nuk e mora (qesh).

Pra në ditën pas zgjedhjeve 1980-ën, në nëntor të 1980-ës, unë në fakt shkova, një mik i imi po punonte në Shtëpinë e Bardhë dhe unë shkova në oborrin e Shtëpisë së Bardhë, në Kopshtin e Trëndafilave dhe e ia bëra me dorë Jimmy Carter-it pasi ai humbi zgjedhjet. Dhe pastaj kalova tek, i ashtuquajtur Bordi i Provuesve të Shërbimit të Jashtëm, të nesërmen, thash, “Oh, e kam provimin me gojë” dhe ata thanë që ka shumë prej neve, kështu që nëse dikush mund të vijë nesër, ne do të kërkojmë që dikush të largohet. Unë thashë, “Mirë shikoni kam një intervistë nesër për atë që ndodhi, kandidimin tim, kandidaturën time të mëparshme, dhe nëse mund të takohem me dikë sot do të isha i lumtur që të kthehesha dhe të ulem në provim, nesër në provimin me gojë”.

Unë shkova lart dhe shokët atje filluan me të zakonshmen, “Epo e dini që është një regjistër dhe një listë pritjeje dhe ne nuk mund të parashikojmë” {imiton sikur po hap një dosje} dhe ai hap dosjen time dhe thotë, “Ne ju ofruam një vend dhe ju nuk u përgjigjët kurrë”. Thashë, “Mos e keni dërguar letrën në Angli?” “Po, saktësisht. {shikon orën e dorës} Pra nuk e di sa keni kohë por mund të shkoni poshtë e kemi një klasë që fillon sot”. Thashë, “Faleminderit” por nuk kisha aq kohë, mund të shkoja në klasën tjetër dhe ajo ishte në janar. Dhe ata thjesht, për shkak të legjislacionit të ri, rinumëruan klasat e hyrjes pra ajo që nuk ju bashkangjita ishte klasa e parë e sistemit të ri dhe jam krenar të them që kam qenë i klasës së dytë gjatë gjithë karrierës sime (qesh).

**Anna Di Lellio:** Unë... Vetëm sa për kureshtje, kur për herë të parë e ke ditur që dëshiron t'i bashkëngjitesh Shërbimit të Jashtëm, ke dashur ta kesh një karrierë ose karrierë diplomatike?

**Christopher Dell:** Po, shkova në kolegji duke menduar se do ta vazhdoja juridikun dhe ndoshta ta ndjek karrierën politike. Dhe mendoj se është pjesë e natyrës sime të kundërt, pas dy javëve të para si student në Kolumbia, kur pashë që 45 përqind e klasës ishin për mjekësi dhe 45 përqind e klasës ishin

për juridikun. Thashë që nuk dua të jem si gjithë të tjerët dhe ishte atëherë, viti i parë, viti i parë po, po, viti i parë isha në një ligjeratë për Teorinë Strategjike me një profesor të quajtur Warner Schilling dhe e kuptova që më pëlqeu shumë. Dhe në atë pikë, me administratën e Carter-it, kishte një numër të profesorëve nga Kolumbia që do të vinin dhe do t'i bashkoheshin administratës. Dhe ata arritën të më bënin praktikant në Departamentin e Shtetit, praktikë në Departamentin e Shtetit, në vjeshtën e vitit të fundit, pra '77-tën, dhe e pashë që më pëlqeu shumë dhe pastaj mora vendim që, a e din, ta ndjek këtë nivel në Oksford për Marrëdhënje Ndërkombëtare dhe t'i bashkohem Shërbimit të Jashtëm. Fatmirësisht, gjithçka shkoi sipas planit {pohon me kokë}.

**Anna Di Lellio:** Pra ju bashkëngjite dhe çka ndodhi? Cila ishte detyra jote e parë?

**Christopher Dell:** Sigurisht, unë u bashkova duke qenë një gjermanofolës, dhe natyrisht, ata më caktuan në një post në Meksikë, ku duhej të mësoja spanjisht. Pra detyra ime e parë, pas rreth nëntë muaj trajnimi përfshirë pesë muaj trajnim në gjuhën spanjolle. Në shtator të '81-tës, shkova në Matamoros, në Meksikë, që është një qytezë në kufi me Teksasin, përball Brownsville, Teksas. Në atë kohë ishte një post me dy oficerë, një këshilltar dhe një zëvendës këshilltar. Më së uliti në shtyllën e totemit të Shërbimit të Jashtëm, duke punuar në një pikë kufitare, larg prej kryeqytetit, Meksiko Siti. Konkretisht lëshimin e vizave joemigurese.

Siç mund ta imagjinosh, kishe shumë lëvizje në kufi, shumica jo ligjore, shumica... një sistem ishte zhvilluar në Meksikë ku për vite me radhë, ata me të vërtetë nuk shqetësoheshin ta siguronin rajonin kufitar. Ata thjesht supozuan se të gjithë do të kalonin përtej kufirit në SHBA për të blerë, po flas për ato baziket, a din, qumshti, buka, a din, shpesh njerëzit shkonin në Brownsville për të marrë. Pra kishte shumë, shumë, shumë njerëz që aplikonin për viza çdo ditë dhe shumica njerëz që do t'ju jepje, edhe pse në rrethana tjera, mund të thoshe, "Jam në dyshime, sepse ky person është ndihmës në fermë a din, dhe ka shanse që në SHBA do të shkoj për të punuar në ndonjë fermë". Por në fakt kishin arsye legjitime për të shkuar.

Unë mendoj se gjëja më interesante në lidhje me atë turneun e parë, edhe pse kishte shumë gjëra interesante, por një nga gjërat që pothuajse çdo zyrtar i Shërbimeve të Jashtme fillon është që të bëjë një turne të këshilltarit. Kjo përfshin një sërë përgjegjësish, por lëshimi i vizave është sigurisht një nga më të mëdhatë, dhe aftësi e rëndësishme është që të mësosh t'ju thuash njerëzve jo. Në shoqërinë tonë, në jetën tonë, nuk bjen shpesh në pozitë që ti thuash dikuj, "Jo, nuk mund të kesh diçka që don me të vërtetë, me të vërtetë shumë".

Dhe të jesh oficer i vizave duhet t’ju refuzosh vizat shumë njerëzve që me të vërtetë dëshirojnë të shkojnë në SHBA dhe duhet të mësosh ta bësh me diplomaci, me butësi por gjithashtu vendosmërisht. Shpesh nejrëzit zemërohen shumë dhe shfryhen para fytyrës tënde, a din, shfryhen shumë. Kështu që mendoj që kjo ka qenë një aftësi e rëndësishme diplomatike, duke mësuar prej bazës e lart, sikur gjithçka ka filluar prej aty. Dhe sigurisht, pa ndryshim, zëvendës këshilltarët marrin aftësitë më të mira gjuhësore të kujtdo, sepse ata përdorin gjuhën më së shumti, duke folur me njerëzit e thjeshtë në çfarëdo gjuhe. Në këtë rast meksikanët, duke e përdorur atë tetë orë në ditë çdo ditë, mendoj se është me të vërtetë e mirë për zhvillimin e aftësive gjuhësore.

**Anna Di Lellio:** Pra posti tjetër ishte në një shtet ku flitet gjuha spanjolle?

**Christopher Dell:** Jo, shkova në Portugali.

**Anna Di Lellio:** Për ta mësuar një gjuhë tjetër?

**Christopher Dell:** Për ta mësuar një gjuhë tjetër. Unë... Pata një aksident të tmerrshëm me makinë, ndërsa isha atje dhe e lëndova veten keq dhe...

**Anna Di Lellio:** Atje, në Meksikë?

**Christopher Dell:** Në Meksikë, në fakt ishte në anën e kufirit të SHBA-ve sepse {bën thonjëza} ka qenë ma sigurt. Nuk doli ashtu, dhe kështu që departamenti u kujdes pak për mua sepse unë, ata thanë që, “Mund të largohesh nga Meksika, ne e kuptojmë”. Unë thashë, “Jo, jo, ta shoh se si po del”. Kështu që, ata më lanë të shkoj kudo që doja për detyrën time të radhës. Që kur isha fëmijë, e dija që i doja verërat e portit<sup>4</sup>, kështu që thash pse të mos shkoj në Portugali dhe të mësoj më shumë rreth verërave porto (qesh). Dhe pata sukses u regjistrova një vit në konsullatë, që nuk e kemi më, por isha konsull në Portel, pastaj një vit në Ambasadën në Lisbon dhe është ende Shërbimi i Jashtëm i preferuar i imi.

Ishte Portugalia, para se të hynte në Evropë, dhe shefi im e përshkruante si më të mirën, ai thoshte, “Portugalia është ashtu si do të ishte Evropa në vitet 1950 sikur të mos ndodhte Lufta e Dytë Botërore. Disi shumë e stilit të vjetër, shumë, po hezitoj ta përdor fjalën por e pazhvilluar, më pak e zhvilluar se sa pjesa tjetër e Evropës. Ka qenë fascinuese ta njohësh atë Portugali dhe t’i shohësh ndryshimet që kanë ndodhur duke bërë ndërhyrje për tridhjetë vjet.

**Anna Di Lellio:** Kur ju caktoheni për një post, sa ju përgatit Departamenti i Shtetit për postin ose sa përgatiteni ju? Çfarë ke ditur për Portugalinë përveç faktit që të pëlqente...

<sup>4</sup> Vera port është një verë e fortifikuar Portugeze e prodhuar me shpirtëra të distiluar rrushi ekskluzivisht në luginën Douro në provincat veriore të Portugalisë.

**Christopher Dell:** Saktë, nuk kam ditur pothuajse asgjë dhe ata ta jepin një trajnim gjeneral për gjuhën nëse nuk e njeh, dhe ka qenë një kurs i konvertimit, për ta konvertuar spanjishten në portugalishte, ka zgjatur vetëm tetë javë. Dy gjuhët janë shumë të ngjashme, a din, mundesh, mund ta mësosh mjaft sa për ta bërë tranzicionin. Dhe çdo javë ata e bënin një studim për vendin, mëngjesi i studimeve të vendit, ku ti lexon, mëson më shumë për shtetin. Por unë mendoj se një nga kritikrat historike dhe të vlefshme të Departamentit të Shtetit është se ata shpesh nuk kanë bërë shumë për të trajnuar oficerët. Thjeshtë është e pritshme që të shfaqeni, shkoni atje dhe të mësoni gjatë punës.

Dhe mendoj që kjo funksionon për shumë njerëz, por për të shumtët jo dhe ata kanë bërë përpjekje serioze prej atëherë për ta përmirësuar kualitetin e parapërgaditjes për oficerët që shkojnë nëpër vende të reja dhe regjione të reja. Por, mendoj se ka ende një element të fortë të të mësuarit ndërsa shkon me Shërbimin e Jashtëm dhe gjëja më e mirë për këtë është se njerëzit që janë studime të shpejta... po mendoj, ju fusin në një kulturë dhe vërtet mësoni shumë, shumë shpejt në një mënyrë që unë nuk mendoj se mund ta mësoni nga një mjedis akademik, ku lexoni libra ose merrni pjesë në ligjerata. Unë mendoj se të dalësh atje dhe të jetosh në shoqëri me të vërtetë është mënyra më e mirë për ta kuptuar atë.

Dhe, a e din Anna [i drejtohet intervistuesës], kjo reflekton... përveç tjerave Shërbimin e Jashtëm, po mendoj i reprezenton Shtetet e Bashkuara, por gjithashtu është edhe një shërbim i inteligjencës, në kuptimin që mbledh informacione. Ulemi me një kontakt të huaj, mëson gjëra rreth shtetit, dhe nuk është vetëm për përfitimin tënd, po mendoj duhet ta informosh edhe Washingtonin për këtë. Pra, përdorimi i fjalës inteligjencë nuk është asgjë e keqe apo e fshehtë, është shumë e qartë, të gjithë e dinë kush jeni dhe kush përfaqësoni dhe çfarë jeni duke bërë.

Por ajo që e bën Shërbimin e Jashtëm unik nga shërbimet tjera të inteligjencës së qeverisë amerikane, përveç natyrës së hapur të tij, është që ne jemi shërbimi i vetëm ku mbledhësi i informacionit është edhe analisti që ju tregon çfarë kuptimi ka. Agjensitë e tjera, Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes për shembull, ata kanë atashe në ambasada që mbledhin informacione për ushtrinë e vendeve lokale, dhe përsëri shumë prej tyre janë shumë të hapura, por analiza e asaj që do të thotë gjithçka bëhet gjithmonë nga analisti që ulet në Washington ose diku në Shtetet e Bashkuara ose gjatë.

Kështu që, Shërbimi i Jashtëm sjell një aftësi unike për të kuptuar një vend nga përvoja e dikujt që jeton atje, jo, natyrisht, si një vendas, por si njeri në rrugë që mundohet me kuptu një vend. Një gjë e zakonshme është të bisedosh me taksistët dhe të marrësh mendimin e njerëzve të zakonshëm, pavarësisht nëse bëhet fjalë për taksistët apo njerëzit nëpër dyqane dhe restorante, apo kudo që i takon ndonjëherë. Kështu që unë mendoj se kjo shton një shkallë të, ajo shton diçka në organizmin e



përgjithshëm të qeverisë amerikane të kuptuarit e një vendi, analistët janë duke bërë të gjitha gjërat e tyre dhe ata kanë shumë burime për të punuar me të, por unë mendoj se dora e parë, në ndjenja e tokës është shumë e rëndësishme. Unë mendoj se është ndoshta kontributi më i rëndësishëm që Shërbimi i Jashtëm bën për politikën e qeverisë amerikane dhe për ta kuptuar botën.

**Anna Di Lellio:** Po, dhe ke thënë një vit në Portugali...

**Christopher Dell:** I kam kaluar dy vite në Portugali. Një vit në Portel dhe në vitin e dytë në Lisbon.

**Anna Di Lellio:** Dhe a ka... po mundohem ta kthej veten në '83-tën,'84-tën. Pra, janë pothuajse dhjetë vite pas përfundimit të Salazarit?

**Christopher Dell:** '75-tën, '74-tën ishte revolucioni.

**Anna Di Lellio:** Po, në shtator, po.

**Christopher Dell:** Po, pra pothuajse dhjetë vite.

**Anna Di Lellio:** Gati dhjetë vite. Si të kanë pritur atje si amerikan?

**Christopher Dell:** Shumë ngrohtësisht.... Portugezët gjithmonë kishin pasur simpati për SHBA-të. Po mendoj është komunitet i madh emigrantësh në Shtetet e Bashkuara. Pra ka shumë ashtu në nivel personal, kontakti konstant i njeriut me njeriun dhe kjo është historikisht e vërtetë. Dua të them, portugezët kolonizatorë më të hershëm ishin gjuetar të balenave të cilët përfunduan në Havai, në bregun perëndimor, në Long Beach. Pra, njerëzit si, Devin Nunes<sup>5</sup>, të cilët janë bërë të famshëm për disa arsye të kohës, familja e tij e ka prejardhjen që nga shekulli i XIX në SHBA. Imigrantët e tjerë janë të kohës së fundit, prej viteve 1960 e tutje.

Mirëseardhje e ngrohtë. Në kohën kur unë isha atje, ata kishin kaluar pasojat e menjëhershme të ndryshimeve dhe nëse kujtoni se kishte një periudhë ku dukej sikur Partia Komuniste e Portugalisë do të vinte në pushtet. Dhe ambasadori i SHBA-ve në atë kohë, Frank Carlucci, i cili u bë i njohur më vonë, ishte aktivist. Henry Kissinger ka qenë në Washington, duke i shtrënguar duart dhe duke thënë, "O Zot, është fundi i botës siç e njohim, komunistët po e marrin pushtetin në Portugali. Së shpejti do të jetë Portugalia, do të jetë Angola, do të jetë Mozambiku, a din, po e humbin Luftën e Ftohtë".

---

<sup>5</sup> Kongresmeni i rangut të lartë republikan nga Kalifornia, dhe një anëtar i ekipit të tranzicionit të Presidentit Trump.

Carlucci, në vend se të shtrëngonte duart, mori vendim për të bërë diçka lidhur me këtë dhe e bëri. *USAID*-i<sup>6</sup> erdhi në Portugali dhe investuan shumë para për të ndërtuar shtëpi në pjesë të vendit ku socialistët ishin më të fuqishëm. Dhe partia socialiste po udhëhiqej nga Mário Soares, tani të gjitha këto etiketime janë në një shkallë të asaj se çfarë kuptimi kanë në kontekstin ndërkombëtar. Pra, komunistët, ata ishin komunistë të rreptë, por, socialistët, mendoj se mund t'i quash socialist demokratik dhe konservatorët ishin në qendër djathtas, ata ishin më shumë të grupuar rreth qendrës.

Sidoqoftë Mário Soares, kjo funksionoi, Mário Soares i fitoi zgjedhjet, me ardhjen në pushtet u tërhoq edhe rreziku që Partia Komuniste të bëhet pjesë e qeverisë. Dhe më pas kjo vendosi fazën për tranzicionin e Portugalisë, disa vjet më vonë, për t'u bërë edhe anëtare e Bashkimit Evropian. Kur isha akoma atje, u hapën shtigjet, por nuk ndodhi dhe ishte ende në diskutim nëse Portugalia... nëse demokracia do të zërë vend dhe të mbijetojë në Portugali. Kishte karaktere misterioze si oficerët ushtarak, të cilët u bënë politikanë, njëri prej tyre ishte edhe presidenti. Politika e tyre ishte e ashpër, çka kanë qenë në të vërtetë dhe kush kanë qenë në të vërtetë. Por unë mendoj se të gjitha u zgjidhën, këtu mendoj se Bashkimi Evropian vërtetoi vlerën e tij, pavarësisht Portugalisë apo Spanjës, i cili hyri në të njëjtën kohë në të vërtetë duke ndihmuar në konsolidimin e demokracisë së atyre dy vendeve dhe konsolidimin e saj në kornizë më të gjerë evropiane, e cila mendoj se ishte kritike për suksesin e projekteve në të dy vendet. A do ta mbante atë qartësinë e vizionit dhe sensin e qëllimit në Ballkanin Perëndimor sot dhe në vitet pasuese?

**Anna Di Lellio:** Do të mbërrimë aty.

**Christopher Dell:** E di (qesh)

**Anna Di Lellio:** Prej Lisbonës, cila ishte detyra jote e radhës?

**Christopher Dell:** Duhet të mendoj. Prej Lisbonës jam kthyer mbrapa në Washington. Pastaj kalova gjashtë vitet e ardhshme në Washington duke bërë një sërë detyrash në Zyrën e Çështjeve Ushtarake Politike. Kam qenë Oficer Junior i zyrës spanjolle dhe portugeze. Pastaj kam punuar në Bisedimet e Bazës Greke për një vit e gjysmë. Pastaj u bëra asistent special i nënsekretarit për Çështjet Ndërkombëtare të Sigurisë. Para se të shkoja në Mozambik si Zëvendës Shef i Misionit në vitin 1991. Pra prej '85-tës deri '91-tën unë isha në Washington duke punuar për Departamentin e Shtetit.

**Anna Di Lellio:** Pra, Mozambiku ishte duke dalë nga një luftë, apo jo? '81-tën.

---

<sup>6</sup> Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) është një agjenci e pavarur e qeverisë federale të Shteteve të Bashkuara që është kryesisht përgjegjëse për administrimin e ndihmës civile të huaj dhe ndihmën për zhvillimin.

**Christopher Dell:** Kur shkova atje ishte ende lufta civile. Përfundoi në tetor të vitit 1992. Kjo është një temë e dytë që më përcjell shumë gjatë karrierës sime. Thashë që gjuha portugeze është njëra por gjithashtu të përfundosh në zonat e konfliktit, është një prej temave tjera. Kur në fillim shkova në Maputo ka qenë e izoluar dhe e shkëputur. Ishte një qytet garnizoni. Ushtria guerile e opozitës, RENAMO<sup>7</sup>, nuk e kanë kontrolluar hapësirën përreth por lëviznin lirshëm andej. Ata mund të sulmonin, të sulmonin në çdo kohë, kështu që kishte një perimetër sigurie, jashtë të cilit ne nuk mund të udhëtonim. Rruga e vetme për të mbërritur në Afrikën e Jugut, që është vetëm 90 kilometra larg, ka qenë me anë të fluturimit.

(Pauzë) rruga ishte shkatërruar, shumë kurthe, automjetet mund të digjeshin dhe rruga disi vetëm shkrihej. Pasi përfundoi lufta kishim mundësi të udhëtonim pak më shumë dhe e shihje që niveli i pasojave dhe shkatërrimeve ishte i jashtëzakonshëm. Mendoj se nuk kam vlerësuar mjaft se sa keq kishte vuajtur vendi deri sa u ktheva në vitin 2014 dhe zona që i mbaja mend nga viti 1994, që kanë qenë shkurre, dua të them, shkurre që zvarriteshin deri në rrugë ishin tani fusha të hapura me fshatra dhe njerëz dhe dyqane. Vendi ishte i gjunjësuar në kohën kur përfundoi lufta civile. Dhe mendoj që arsyeja pse nuk u bë aq publike dhe nuk u kuptua mjaft, është për shkak se lufta përfundoi atëherë. Dua të them se kishte shumë libra të ndryshme lidhur me vendosjen e paqes në Mozambik dhe rolin e Sant'Egidio dhe qeverisë italiane dhe kishës dhe të gjitha këto.

Një faktor natyror që luajti rolin e saj ishte thatësira shkatërruese që goditi Afrikën Jugore më '91, '90, '91, në të vërtetë '94-tën, '93-tën, mendoj se atëherë filloi të prishet. Në atë kohë qeveria amerikane po sillte gjashtëqind mijë ton misër në vit dhe mbante gjallë rreth dhjetë milion njerëz. Për shkak se situata e sigurisë ishte ajo që ju mund të dilni vetëm në pika të caktuara ku kishte siguri të mjaftueshme ku mund të lëviznin punonjësit e ndihmës, ju e dini Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, World Vision, dhe njerëzit ishin aq të dëshpëruar sa filluan të dilnin nga shkurret në këto pika ku ata mund të aksesonin ushqimin. Dhe në thelb do të thotë se as qeveria as RENAMO, opozita, s'mund t'i kontrollonte më.

Ata disi i shfrytëzuan njerëzit, këtë e pash më vonë edhe në Angola, e njejta gjë, i mbanin njerëzit e mbyllur në një vend. A din, duke i vrarë ata nëse largohen, ajo strategji u prish prej dëshpërimit të njerëzve që mundoheshin të gjenin ushqim dhe u larguan dhe RENAMO e gjeti veten të izoluar dhe nuk kishte mundësi ta kontrollonte popullin, dhe a din, secili revolucionar... {bën thonjëza} lëvizja fshatare varet nga kontrollimi i popullit. Mendoj se ky ishte një faktor shumë i rëndësishëm për të ndihmuar në

<sup>7</sup> Rezistenca Kombëtare e Mozambikut është një organizatë militante dhe lëvizje politike e formuar në vitin 1975, si pjesë e një reagimi të ashpër antikomunist kundër partisë qeverisëse të vendit.

përfundimin e luftës. Me një çmim të tmerrshëm, që askush nuk do ta donte por natyra e ka marr rrydhën e vet. Dhe prej, po... ky ishte Mozambiku, një përvojë e madhe.

**Anna Di Lellio:** Ishte pikërisht në kohën e luftës në Jugosllavi. A ke qenë, padyshim që ke qenë i zënë me ato që ndodhnin në Mozambik për ta përcjellur...

**Christopher Dell:** Nuk e kam përcjell për së afërmi, e vërtetë. Nuk kisha përvojë të mëparshme në atë pjesë të botës. Emrat ishin abstrakt për mua.

**Anna Di Lellio:** Dhe ishe shumë i zënë.

**Christopher Dell:** Dhe ishim mjaft të zënë në Mozambik, po. Fillimisht, duke u munduar t'i jepim fund luftës dhe pastaj duke negociuar për marrëveshjen e paqes. Duke u marr me demobilizimin e luftëtarëve të RENAMO-s. Dhe nganjëherë është qesharake sepse në atë kohë, E kam parë më pas gjithë këtë letërsi teorike që është zhvilluar rreth asaj, se si i përfundon luftërat dhe i demobilizon luftëtarët, dhe më duket se sa herë ju kthehem e kanë shtuar një D apo një R te Disarmatimi, Demobilizimi, Rivendosja, Rimarrja DDDR, mendoj që ka arritur deri te DDDR apo diçka e ngjashme.

**Anna Di Lellio:** DDR, Rivendosja.

**Christopher Dell:** Po shpiknim gjëra, mbaj mend një çift i stafit të AID në zyrën time realizuan, "Oh, po, duhet të marrim kanaçe kallaji dhe duhet të marrim enë prej kallaji, në mënyrë që këta djem të kenë diçka ku gatuajnë dhe prej ku të hanë". Dhe pastaj ata të AID dilnin dhe i blenin i sillnin, enët prej kallaji dhe kanaçet prej kallaji edhe batanijet, edhe mbulesat, plastikën, mbulesat e kaltërta prej plastike që UNHCR-i i përdor në shumë vende si mbulesa. Kështu që po i shpiknim këto gjëra pa i pasur. Mund të ketë qenë, nuk e di nëse ka qenë absolutisht e para, por mund të ketë qenë një nga llojet e para të konflikteve të armatosura të kësaj natyre që do të përfundonin përmes një zgjidhjeje të negociuar dhe duke u përpjekur t'i përpunonim këto gjëra. Kështu që nuk e përcillja Jugosllavinë aq prej afër (qesh), në atë pikë.

**Anna Di Lellio:** Mund ta imagjinoj. Cili ishte roli i..., ti më the që gjithashtu po negocioje për paqe, si një diplomat amerikan?

**Christopher Dell:** Po, kështu që ishte një proces zyrtar për paqe. Partia në pushtet FRELIMO<sup>8</sup>, qeveria dhe RENAMO, opozita, kanë qenë në tavolinën për negociata. Mendoj, kryesisht përpjekjet e qeverisë

---

<sup>8</sup> Fronti Çlirimtar i Mozambikut (FRELIMO) ishte një parti politike mbizotëruese në Mozambik. E themeluar në vitin 1962, FRELIMO filloi si një lëvizje nacionaliste që luftonte për pavarësinë e Provincës Portugeze të Mozambikut.

italiane. Italianët kishin një aksion të madh në Mozambik në ato ditë, pasi sistemi funksiononte në ato ditë, siç e dini, të gjitha partitë politike italiane kishin vende të ndryshme që ishin lloji i tyre, dhe nga të cilat ata fituan para për operacionet e partive të tyre politike në Itali me ndërmarrje ndërtimi dhe gjëra të tilla dhe demokratët e krishterë ishin Mozambiku, kjo ishte pjesa e tyre.

Dhe, kështu, italianët ishin në gjendje të bashkonin partitë, ju e dini, dhe ne ishim shumë me fat, unë mendoj se Italia e mori këtë rol atje. Portugalia kishte shumë bagazhe koloniale dhe histori, Afrika e Jugut ishte, siç e dini, jo një bashkëbisedues i vlefshëm, dhe ata po shkonin, megjithë tranzicionin e tyre, i cili po ndodhte në të njëjtën kohë, në vendin fqinj. Siç e dini, Mandela, Mandela ishte liruar nga burgu, dhe ata filluan këtë diskutim kushtetues i cili çoi në zgjedhjet në '94-tën, të cilat unë u detyrova të shkoj dhe t'i vëzhgoj.

Kështu që ata filluan të negociojnë, dhe ata negociuan një armëpushim të pjesshëm para kohës sime në Mozambik dhe vendosën dy korridore, Korridorin Limpopo dhe Korridorin e Beira, si zona të ndalimit të zjarrit. Kjo ishte që përmenda ku punëtorët e AID mund të dilnin dhe të sjellin ushqim dhe ilaçe për njerëzit në nevojë. Korridori i Beira u shtri nga qyteti i Beira në Oqeanin Indian deri në kufirin e Zimbabves dhe ishte një tubacion rrugor, hekurudhor dhe i naftës, dhe zimbabvianët po e ruanin atë, duke parandaluar çdo konflikt të mëtejshëm. Ata gjithashtu po e ruanin Korridorin Limpopo, e cila ishte një hekurudhë që shkonte prej Puto deri në Zimbabve. Mozambiku kishte shërbyer gjithmonë si një rrugë tranziti për pjesën e brendshme të Afrikës për shkak të pozicionit të saj në bregdet dhe në kohërat koloniale britanikët me të vërtetë morën rrugët e ndërtimit të plumbit në brendësi. Të kujdeset për atë Rodezinë edhe Afrikën e Jugut, Malavi, Zambia, e të tjera.

Ishte një armëpushim i pjesshëm dhe palët u kishin kërkuar të gjithë të marrin pjesë në të. Italianët, Portugezët, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar, nëse më kujtohet mirë, ata ishin katër anëtarë të diçkaje të quajtur Komisioni i Verifikimit të Përbashkët, i cili mbikëqyri këtë proces. Dhe dalja nga ai [proces] ka qenë një negociim më i madh se zgjidhja e tërë konfliktit. Dhe të njëjtët lojtarë ndërkombëtarë të udhëhequr nga italianët, portugezët, Mbretëria e Bashkuar, SHBA, disa nga vendet afrikane luajtën një rol, pak më shumë në anën e JVC, mendoj që kenianët u pajtuan me këtë. Sidoqoftë, ne po merrnim pjesë me kërkesën e palëve që donin ndërmjetës të ndershëm, vëzhgues të jashtëm, ndërmjetësues. Të ulësh mes tyre dhe t'i radhitësh çështjet, sfidat dhe vështirësitë që shfaqeshin.

Procesi zyrtar u zhvillua në Romë, nën kujdesin e qeverisë italiane, dhe në heshtje në prapavijë, komuniteti fetar Sant. Egidio, i cili natyrisht është i vendosur edhe në Romë. Luajtën një rol të rëndësishëm si ndërmjetës, duke biseduar me të dyja palët, ata u vlerësuan si ndërmjetës të ndershëm

nga të dyja palët dhe të gjithë disi bashkëpunuan. Ne ishim me fat që italianët kryesuan. Ata e kishin një ambasador shumë të aftë Manfredo Incisa Di Camerana, nëse më kujtohet, Incisa Di Camerana, që ishte shumë i mençur, shumë, shumë diplomat i mirë, dhe natyrisht italianët mund të bënin gjëra për të kapërcyer pengesat në mënyrat që Shtetet e Bashkuara kurrë nuk mundën. Unë po flas këtu për para. Se ndihmoi palët të plotësonin disa nevoja të caktuara që kishin, kjo i lejoi ata të vazhdojnë me procesin.

Njerëzit e RENAMO-s, kur dolën nga shkurret, kishin veshur lecka, kështu që në një nga udhëtimet e tyre të para në Romë, të gjithë morën suita dhe veshje, në mënyrë që të ndjeheshin se ishin të denjë, jo diplomatë, por negociatorë të denjë në një proces zyrtar ndërkombëtar. Është e lehtë të qeshësh dhe të tallesh me këto gjëra, dhe t'i rrotullosh sytë ndaj korrupsionit, por këto janë kërkesa njerëzore, dua të them që njerëzit kanë dinjitet dhe respekt, dhe ti e di, ata duhet të mendojnë se mund të përmbushin rolet e tyre me një dukje dinjitoze. Ishte shumë e rëndësishme, SHBA-ja nuk do ta bënte kurrë këtë, ne kurrë nuk do të mund të shpenzonim para në atë mënyrë. Ishte shumë e rëndësishme që ata e luajtën këtë rol, dhe ishte një sukses, më e rëndësishmja se pati sukses.

Dhe megjithëse kur u ktheva në Mozambik në vitin 2014, gjithçka ka qenë jashtëzakonisht... siç them gjithmonë me gjysmë shaka, sikurse them edhe për Kosovën, është njejtë sikur largohesh prej serialit tënd të preferuar për një dekadë dhe i kthehesh, dhe asnjë prej aktorëve nuk kanë ndryshuar, dhe asnjë prej çështjeve nuk ka ndryshuar, dhe nuk ka kurrë, a din, dikush u divorcua, dikush ka vdekur, dikush e ka tradhtuar dikë, por ka qenë e njejta fabul. Ishte e lehtë të kuptosh. Por gjëja më e rëndësishme në lidhje me Mozambikun është, pavarësisht nga fakti se RENAMO ende mbante një opozitë të vogël të armatosur në qendër të vendit, nuk kishte asnjëherë rrezik të kthehej në luftë civile. Kur lufta mbaroi, ajo mbaroi {godet grushtin me pëllëmbë}.

Dhe unë kam mbajtur gjithmonë... shumë ndërkombëtarë e donin procesin e pajtimit, procesin e paqes dhe të pajtimit, edhe mozambikasit, vetë njerëzit mozambikanë, dukej që nuk e ndjenin nevojën për këtë. Unë gjithmonë mendoja se lufta ishte po aq e tmerrshme, dhe kujtimet e tyre kolektive të luftës ishin të tmerrshme për të gjithë. Ata thjesht donin ta vinin atë pas tyre dhe të lëviznin para, të gjithë kishin vuajtur, të gjithë ishin të varfër dhe ata nuk kishin kohë të shqetësoheshin për zgjidhjen e problemeve të kaluara, ata thjesht donin, ata duhej të merreshin me vazhdimin e jetës, disi, duke u marr me korrjen e tokës, duke e organizuar jetën e tyre. Dhe jo në mënyrë perfekte, por në përgjithësi ka funksionuar në Mozambik. Mendoj se ka funksionuar edhe në Angolë, e cila është një shoqëri shumë e ndryshme, megjithatë një trashëgimi e përbashkët koloniale. Por përsëri, njerëzit thjesht

duan të përparojnë pas luftës, të fillojnë me jetën. Mund të flasim për këtë më vonë. Ajo përfundoi në një mënyrë shumë të ndryshme, me një rezultat krejt ndryshe.

Kështu që unë mendoj se Mozambiku ishte një histori suksesi. Unë e vlerësoj shumë këtë për rolin e luajtur nga një italian tjetër, Aldo Aiello, i cili u emërua nga KB si Përfaqësuesi Special atje për të udhëhequr procesin e paqes, misioni i KB-së i quajtur ONUMOZ, dhe është një nga më të suksesshmit prej këtyre misioneve të paqes që KB-ja ka ngritur ndonjëherë. Dhe përsëri i besoj shumë Aldos, dhe aftësive të tij personale, ai ishte një politikan italian, mendoj se ai ka qenë senator në Itali. Por ai jetoi shumë në Nju Jork dhe unë e kuptova se ai ishte ai kombinimi i përsosur i llojit makjavellian, politikan italian, por edhe një Amerikan shumë pragmatik.

Përqendrohesh në cak dhe kurrë nuk e humb mendjen se cili ishte objektivi. Unë mendoj se ishte një ekuilibër i mirë dhe sigurisht që ai kishte një marrëdhënie shumë të ngushtë me Ambasadën Italiane dhe Qeverinë Italiane e cila vazhdoi atë rol pozitiv që kishte luajtur Italia. Por ai ishte shumë i aftë dhe sa herë që procesi do të mbërthej, ai ishte në gjendje të, në një mënyrë të negociojë midis palëve. Bëri thirrje vendeve të tjera që ishin duke i mbështetur, si Shtetet e Bashkuara apo italianët ishin të aftë t'ju ndihmojnë t'i kalojnë ato pengesa. Shumicën prej të cilave, ka kohë që i kam harruar, i kujtoj vetëm skicat e procesit.

## Pjesa e Dytë

**Anna Di Lellio:** Në rregull, pra pas Mozambikut.

**Christopher Dell:** Po, pas Mozambikut u caktova në Departamentin e Shteteve në një punë që merrej me çështjet e NATO-s në Byronë Evropiane. Dua të them që kam pasur njëfarë prapavije në çështjet e Evropës dhe NATO-s, më parë. Nga përvoja ime e mëparshme, kështu që unë u bëra Zëvendës Drejtor i zyrës atje dhe isha përgjegjës për pjesën e NATO-s të asaj zyre. Dhe ishte një kohë shumë interesante, ju kujtohet, kjo ishte pesë vjet pas rënies së Murit të Berlinit. Pyetje të mëdha do të bëheshin për të ardhmen e Evropës dhe strukturat e sigurisë dhe vendet ku më parë kanë qenë pjesë e paktit të Varshavës.

Kjo ishte vera e vitit '94, unë u ktheva dhe Presidenti Clinton kishte vendosur që ai mbështetë idenë e zgjerimit të NATO-s, të sjelljes së anëtarëve të rinj brenda dhe punësoi Richard Holbrooke të jetë Ndihmës Sekretar për Evropën në mënyrë që ta realizonte këtë. Dhe, unë duhet të them Anna, ishte përvoja ime më e keqe profesionale kur kam punuar me Richard Holbrooke, i cili ishte një njeri i

vështirë. Kjo nuk është shumë e popullarizuar në qarqe të caktuara, unë e di, ta them këtë, të flasë të vërtetën lidhur me këtë, por ai ishte një njeri brutal për të punuar për të. Unë kam pasur shefa të ashpër më parë, por Holbrooke, në njëfarë mënyre ishte i dashuruar me madhështinë e tij dhe nuk ishte i trembur që t'ju bënte me dije, dhe gjithashtu një ngacmues nga natyra. Kështu që, ai pëlqente t'i bënte njerëzit të ndjehen të vegjël, kështu që nuk ishte një përvojë e mirë. Gjëja më e mirë që më ndodhi ndonjëherë ishte tragjedia në Sarajevë, ku Amerikani Bob Frasure dhe dy njerëz të tjerë u vranë në një aksident në malin Igman.

**Anna Di Lellio:** Ron Brown?<sup>9</sup>

**Christopher Dell:** Po, dhe Holbrooke u kthye prej aty, në ndërkohë Holbrookut i kishin thënë që të bënte paqe në Jugosllavi. Dhe ishte interesante ta shikosh atë duke u përpjekur të shmangte etiketimin me këtë sepse ai e dinte që ai ishte vendosur për një proces të dështuar dhe ai nuk dëshironte të ishte pjesë e atij [procesit]. Ai po përleshej duke u përpjekur të dilte prej kësaj. Por detyrimisht, ju e dini, bëri atë që i thanë dhe u përfshi dhe më pas ndodhi kjo tragjedi në malin Igman dhe ai u kthye i transformuar. Dua të them që pashë kur shkova në aeroport me shumë kolegë të mi nga Byroja Evropiane për ta pritur aeroplanin ku ata sollën kufomat mbrapa ishte edhe Holbrooke i cili doli nga aeroplani dhe ishte i tronditur, dua të them që mund të shihej ajo.

Dhe meritë e tij ishte, dua të them, kjo pati një ndikim të thellë psikologjik që ai të vendosë, megjithë vendosjen në Washington, dhe politikën e keqe, dhe vështirësinë e mëdha të problemit, ai do ta bënte atë të funksiononte. Dhe jashtë kësaj Procesi i Dayton lindi, dhe më duhet të them, dua të them, ju e dini, me të gjitha kufizimet e tij, ishte një sukses i vërtetë. Unë mendoj se është për shkak të shtytjes personale dhe angazhimit të një njeriut. Për mua, lajmi i mirë ishte se ajo që e largoi atë nga mundimi që ma bënte çdo ditë për zgjerimin e NATO-s, që ishte çështje e madhe nga ana e NATO-s. Ai thjesht nuk kishte kohë të shqetësohej më për të. Ishte shumë më e lehtë të punosh në këto çështje pa parachutizimin e tij çdo gjashtë javë dhe duke të thënë që je budalla dhe nuk e di se çfarë po bën dhe fillo përsëri.

Një nga gjërat më interesante që ndodhi ishte Asambleja e Përgjithshme e OKB-së që po ndodhte në New York. Kjo duhet të ketë qenë, duhet të ketë qenë vjeshta e vitit '96, po i harroj datat tani, ose '95 ose '96, duhet të ketë qenë viti '95. Po, '95 dhe telefonon dikush dhe është Dick Holbrooke. {imiton telefonatën} "Chris, kam një takim me Tudjman dhe blla, blla, blla. Duhet të vish dhe të merresh me takimin Quintit". {bën sikur mbyll telefonin} Tani Quint ishte, ju e dini, SHBA-të, Gjermania, Franca,

<sup>9</sup> Ron Brown, Sekretari i Tregtisë i Presidentit Clinton vdiq në një aksident në Kroaci.



Mbretëria e Bashkuar, mendoj se ishte mbledhja kuadratike. U mbajt nga drejtorët politikë dhe ja ku jam, një oficer i nivelit të mesëm në Departamentin e Shtetit.

Unë hipa në aeroplan dhe shkova në New York. Drejtorët politikë, Ministria e Jashtme britanike, Ministria e Jashtme gjermane, të gjithë këta njerëz, Pauline Neville-Jones dhe Wolfgang Ischinger, të gjithë këta diplomatë shumë të moshuar, si dhe ky ZSHJ [Zyrtari i Shërbimit të Jashtëm] askushi, i ulur aty duke e përfaqësuar Holbrooke dhe duke u thënë atyre çfarë do të ndodhte dhe si do të duhej të ishte. I pash të gjithë, {tund kokën} ishin te pakënaqur prej kësaj shuplake në fytyrë prej Holbrooke, që mendoj se ka qenë e qëllimshme.

Sidoqoftë, kam kaluar, kam kaluar, dy vjet duke punuar për zgjerimin e NATO-s. Unë isha autori kryesor, kam shkruar udhëzimet e qeverisë amerikane për kolegët tonë të NATO-s, duke negociuar këtë proces. Quhej *Studimi i zgjerimit të NATO-s* dhe ishte menduar të ishte një studim mbi atë se a duhet të zmadhohet aleanca apo jo, në çfarë rrethanash dhe si, dhe natyrisht, shumë kundërshtime lidhur ndaj tij brenda Aleancës. Shumë kundërshtime që vinin nga Moska, që mendoj se është e denjë për tu thënë, vazhdon e njejta edhe sot, por në fund studimi u aprovua. Pastaj disa vjet më vonë u vendos skema për zgjerimin e parë. Polonia u inkuadrua dhe... o Zot kam harruar tani kush tjetër. Ishte fillimi i një procesi, i një radhësie të zgjerimeve.

Dhe shumë historianë revizionistë flasin se si SHBA ishte e gabuar për të udhëhequr këtë proces, dhe ishte gabim që NATO-ja të zgjerohej, dhe kjo ka sjellë një shije të keqe, dhe kjo ka bërë që Putini të jetë ai që është sot në kërkimin e hakmarrjes për poshtërim. Dhe ajo që revizionisti harron gjithmonë me lehtësi ishte përpjekja e jashtëzakonshme e bërë për të përfshirë Rusinë në këtë proces. Për të gjetur mënyra të reja për të arritur që të përfshihen edhe ata, jo si aleat, por në një marrëdhënie më të ngushtë me NATO-n. Unë mendoj se SHBA-të madje edhe nuk e pëlqyen idenë, pak a shumë, që Rusia të bashkohen në NATO, por Evropianët nuk do të kishin të bëjnë me këtë, diçka që harrohet shpesh.

Ata që ishin më të afërt nuk donin asgjë të bënin me të. Por mendoj që aty ku analiza e revizionistëve gjithmonë dështon është se çfarë do të kishin bërë me të gjitha ato shtete nëse nuk ju kishin ofruar rrugën drejt perëndimit: Polonia, Hungaria, Çekosllovakia, mendoj që atëherë ende quhej kështu, e të tjera, të gjitha këto. Ku i lë këto? Bllokuar në një zonë gri, midis Moskës së zemëruar dhe të hidhëruar, duke parë perandorinë e saj të vjetër të zhduket prej saj dhe perëndimit gjithnjë e më të prosperuar dhe të integruar. Dua të them që nuk kishte zgjidhje të tretë. Dua të them që ato do të ishin pjesë e diçkaje, çka do të ishte ajo?

Dhe unë mendoj se vendimi ishte i duhuri, për t'i afruar ata me Perëndimin dhe për të bërë atë që ishte bërë për ta, ajo që ishte bërë për Portugalinë dhe Spanjën një dekadë më parë, për t'ju ofruar atyre një vend në strukturën perëndimore. Ato kanë qenë prej kohësh të dyja aleatë të NATO-s, por BE-ja këtu... Dhe unë mendoj se kjo ishte thirrja e duhur dhe ishte një vendim vizionar për t'u ofruar atyre stabilitet dhe siguri të një pjese të madhe, të diçkaje më të madhe dhe diçka që ishte pro-perëndimore dhe demokratike, liberale demokratike në orientimin e saj. Unë mendoj se sukcesi i atyre vendeve pas vitit 1989 flet vetë, përgjithësisht. Ata që u sollën në fillim kanë bërë më të mirën, ato që kanë mbetur pas kanë vuajtur më së shumti dhe ato janë me të vërtetë, deri më sot nuk kanë bërë aq sa vendet që erdhën në fillim.

**Anna Di Lellio:** Dhe kjo ishte koha kur filluat të njiheshit pak më shumë me situatën.

**Christopher Dell:** Në regjion, po.

**Anna Di Lellio:** Jugosllavi.

**Christopher Dell:** Po, dua të them që u përfshiva në këtë. Detyra ime, në takimin e parë të Dayton ishte të organizoja sanduiçët për negociatorët (qesh) por kjo është tipike që një diplomat në karrierë të përfshihet në këtë nivel.

**Anna Di Lellio:** Pra ke qenë në Dayton?

**Christopher Dell:** Jo, jo ka qenë në Washington.

**Anna Di Lellio:** Në Washington.

**Christopher Dell:** Para se të lëviznin. Holbrooke kuptoi që duhej t'i izoloj të gjithë nga shpërqëndrimet dhe syri i medias, kështu që i ka mbajtur të struktur, më vonë. Dhe atëherë e gjetën bazën ajrore për ta bërë atë. Por, unë gjithmonë isha tangjencial me procesin e Dayton, nuk isha përfshirë vërtet thellësisht në të.

Ekspozimi im i vërtetë në rajon fillon me caktimin tim tjetër, që ishte në Bullgari. Kisha pasur fatin e mirë, të njohja dhe të punoja për të, kur isha në tryezën e Spanjës dhe Portugalisë, drejtoreshën e zyrës ishte një grua me emrin Avis Bohlen. Ajo është vajza e një diplomati shumë të famshëm, Chip

Bohlen, i cili ishte një nga *The Wise Men*<sup>10</sup>[Njerëzit e mençur], President i Krijimit. Dhe më pas ajo ishte në një pozitë më të lartë në Byronë Evropiane dhe unë po punoja për çështjet e NATO-s.

Dhe ajo më pas u emërua të jetë Ambasadore në Bullgari dhe ajo më pyeti nëse do të shkoja së bashku dhe të isha zëvendës i saj. Unë thashë menjëherë, po, mendova se ishte një mundësi e mahnitshme, sepse ajo ishte një diplomate shumë e aftë dhe një, një shefe shumë e mirë. Them se me të vërtetë më pëlqen, ne jemi miq edhe sot e kësaj dite. Dhe kështu që ky ishte ekspozimi im i parë, hera e parë që shërbeja, atë që ne e quanim Evropa Lindore, jo quhet Evropa Qendrore e Jugut, besoj (qesh). Unë shkova dhe bëra një vit trajnim në gjuhën bullgare. Kalova në Sofje, pastaj në verën e 1997.

**Anna Di Lellio:** Kur edhe filluan të ngriten tensionet në Kosovë?

**Christopher Dell:** Tensionet filluan të ngriten në Kosovë. Bullgaria po kalonte nëpër krizën e vet, ekonomia e tyre kishte kollapsuar në vitet '96 '97. Dua të them që kishte mungesë të ushqimit dhe për gjithçka tjetër në atë pikë. Shteti ishte duke dalur nga implikimi i vet ekonomik. I kishim duart e zëna aty, prapë, duke bërë shumë, duke ju ndihmuar, në mënyrë që disi të rimëkëmben prej pikës së ulët ku kishin arritur. Pra jam përfshirë në Kosovë, pak a shumë, po mendoj kishte probleme qysh herët me kontrabandimin e naftës në Jugosllavi nga Bullgaria, e din, sillej njëfarë tregu i zi. Me të vërtetë u përfshiva në kohën e fushatës ajrore të NATO-s. Unë, edhe sot e kësaj dite, pohoj se kam qenë, nëse jo i vetmi, njëri prej të vetmëve diplomat amerikan i cili ra në zjarr gjatë fushatës ajrore.

**Anna Di Lellio:** Literalisht apo metaforikisht?

**Christopher Dell:** Po kam qenë... afër literalisht. Ku jetoja në Sofje kam qenë në periferinë e pjesës perëndimore të qytetit dhe një natë isha në palestrën të cilës i takoja, po bëja dush, dhe u dëgjua një shpërthim i madh, dhe njëra prej raketave tona gabimisht ishte përplasur në kulmin e një shtëpie që ishte një kilometër larg prej ku unë po qëndroja. Pra, mendoj se kjo më lejoi të them se erdha më afër se kushdo tjetër për tu qëlluar. Del që raketa, si vera e mirë, karburanti i raketës vjetërsohet dhe digjet më ngadalë. Dhe gjatë fushatës ajrore, këto raketa anti-radar që kishim, e din, ne ju hedhnim jugosllavëve, të cilët kishin mësuar t'i fiknin radarët e tyre mjaft shpejt, dhe pastaj raketa shkonte në modalitetin e kërkimit, duke kërkuar një objektiv.

<sup>10</sup> "The Wise Men: Six Friends and World They Made" (Njerëzit e mençur: Gjashtë Shokë dhe Bota që Ata Krijuan) është një libër jo fiktiv, autorët e të cilit janë Walter Isaacson dhe Evan Thomas. Libri identifikon gjashtë persona që ishin këshilltarë të rëndësishëm të politikës së jashtme për presidentët e SHBA nga Franklin D. Roosevelt deri te Lyndon Johnson dhe ishin me ndikim në zhvillimin e politikës së jashtme të epokës së Luftës së Ftohtë për Amerikën.

Bullgarët ishin duke përdorur të njëjtat radare dhe ishin kureshtarë dhe po shikonin se çfarë po ndodhte me radarin e tyre, kështu që raketat kapnin sinjalin bullgar. Dhe kështu e kuptuam më vonë, se ishin gjashtë nga këto raketa që goditën brenda një kilometri në secilën anë të një linje të drejtë në atë pjesë të radarëve në Bullgari. Ne u thamë bullgarëve se ata me të vërtetë duhet ta fikin radarin e tyre sepse herët a vonë do të goditej. Dhe ishte përtej rrezes së këtyre raketave, sepse karburanti ishte i vjetër, dhe raketat udhëtuan më ngadalë por në distanca më të gjata. Kështu u gjeta në zjarr në luftën ajrore në Kosovë (qesh).

**Anna Di Lellio:** Vitin tjetër do të jetë 20 vjetori i intervenimit.

**Christopher Dell:** Tashmë.

**Anna Di Lellio:** Po, çfarë mendon lidhur me intervenimin në atë kohë, nëse mund të më tregosh? Në atë kohë a ke menduar që ka qenë gjëja e duhur për ta bërë?

**Christopher Dell:** Po shumë, po mendoj, dija mjaft lidhur me këtë, çfarë po ndodhte në atë pikë, për ta kuptuar spastrimin etnik agresiv që Kosova po e kalonte prej serbëve dhe unë besoja që duhej të ndalohet. Kështu që kurrë nuk kam pasur dyshim lidhur me intervenimin. Ne të gjithë tejkaluam Bosnjën dhe Kroacinë dhe të gjitha këto luftëra. Dhe disi ishte një situatë që nuk mund të qëndroje duarkryq dhe të shpreste që Millosheviq në Beograd do të filloj të sillet mirë. Kështu që nuk kam pasur kurrë asnjë dyshim për korrektësinë e vendimit për të intervenuar dhe për ta ndaluar Serbinë në rrugëtimin e saj.

Unë mendoj se ne e bëmë kaq në mënyrë efektive, me një humbje minimale të jetëve në të gjitha anët. Mund të flasim për disa nga pasojat e rendit të dytë të asaj në vende si Afganistani më vonë. Por nuk jam i sigurt se do të kishte nëse ne nuk do të kishim adoptuar taktikat tona, të përshtatnim taktikat tona. Ishte mjaft e qartë që sulmet ajrore nuk po funksiononin, kështu që unë mendoj se kishe nevojë për partneritet me njerëzit në terren, domethënë UÇK-në. Diçka që mësuam gjatë kësaj, mendoj se atëherë e bëri ndërhyrjen tonë shumë më efektive dhe sigurisht që Millosheviqi ndryshoi taktikat e tij, dhe pastaj filluam. Dua të them që përkrahja për këtë ishte e luhatshme në Perëndim; por kur filluan të dilnin imazhet e popullit të dëbuar dhe, në një mënyrë u detyruan të ecnin nëpër linjat hekurudhore si dhe refugjatët në Maqedoni, e të tjera. Unë mendoj se ai e përcaktoi fundin e vet në atë pikë, taktika e tij dështoi, ai nuk e mori parasysh reagimin e publikut perëndimor për imazhet që dolën. Mendoj se kjo e përshpejtoi mbështetjen për ndërhyrjen në kohën kur ajo ishte e lëkundur dhe na lejoi ta shtyjme drejt suksesit.

**Anna Di Lellio:** Kur ishte hera e parë që shkove në Kosovë?

**Christopher Dell:** Hera e parë ishe në shkurt të vitit 2000, mbase në fund të janarit, por mendoj se ishte shkurti. Dhe, ndoshta ju kujtohet, që ishte një dimër shumë i ashpër, shumë i zymtë, kam udhëtuar nga Sofja për në Shkup, dhe atje më priti një sigurim, i cili më çoi në grykën e Kaçanikut e në Prishtinë. Nuk e mbaj mend grykën aq qartë, mbaj mend që po dilja nga ajo dhe kishte fusha boshe, të zbehta, gjithçka ishte gri dhe kafe, bari ishte rritur, plehra kishte kudo dhe ne ishim të mbërthyer pas një transportuesi gjerman tank, duke lëvizur deri në kthimin në Prizren, dhe e vetmja ngjyrë që mbaj mend që e kam parë kanë qenë flamujt shqiptarë dhe flamuri amerikan, kudo që shikoja, këta dy flamuj. Kjo ishte përshtypja ime e parë, mjaft dramatike, dhe më pas arritja në Prishtinë. Natën e parë që isha atje, shkuam për të darkuar, fillimisht të parën natë prej dy netëve, po qëndronim në të njëjtin objekt ku është ambasada e SHBA-ve sot, por të gjithë jetonin në një dhomë, si një lloj shtate konvikti. Gjithçka ishte shumë primitive, nuk kishte shërbime, kështu që kishte gjeneratorë të mëdhenj të epokës së Vietnamit që punonin gjithë ditën dhe natën për energji elektrike në kompleks.

Por shkuam për darkë në rezidencën e Bernard Kouchner diku në qytet, por vetura jonë e madhe e blinduar nuk mundi të ndalej në kodër. Pra ne rrëshqitëm si nga tobogani poshtë kodrës. Nuk e di se si ne nuk u mbytëm të gjithë, pra djali që ngaste ishte i shkathët. (qesh) Kishte shumë akull. Sigurisht që askush nuk kishte pastruar dëborën ose akullin atë dimër, pati një prishje të plotë të të gjitha shërbimeve, asnjë mbledhës i plehrave. KEK-u ishte, ju e dini, në atë masë sa funksiononte, po nxirrte dëborë, kur binte dëborë, binte borë e kuqe, prej asaj çfarëdo që ishte që dilte nga pargjet e tymit. Ishte një lloj kujtimi im i hershëm vizual i asaj çfarë ishte Kosova.

**Anna Di Lellio:** Pse ishe ti atje?

**Christopher Dell:** Në nëntorin e vitit '99, Bill Clinton erdhi në Sofje. Ne organizuam një vizitë të sukseshme nga Clinton. Vizita e parë ndonjëherë nga një President i Amerikës në Bullgari dhe disa nga zyrtarët e lartë në Byronë Evropiane mu afruan dhe më thanë, “Po kërkojmë dikë që të drejtojë zyrën amerikane në Prishtinë, a do të ishit i interesuar?” Dhe thashë, “Mirë më lër të flas me gruan time, por në parim, po”. Dhe kjo është ajo që ndodhi.

Në shkurt, personi që kishte hapur zyrën, Larry Rossin, një koleg, po largohej, dhe ata donin që unë të shkoja atje dhe ta zëvendësoja atë për të paktën një javë, vetëm sa për të marrë një mendim për gjërat, dhe thjesht të shikoja se çka ishte, kështu që shkova. Unë po përgatitesha të kaloja në zyrën në SHBA. U ktheva në Sofje, përfundova punët e mia deri në një pikë dhe pastaj u ktheva në Prishtinë, diku një javë ose dy më vonë.

Ndërkohë palestra ishte djegur. Ju kujtohet ajo ndërtesë e madhe që ishte qendra e vjetër sportive apo diçka e tillë, nga kohërat e Jugosllavisë, ishte djegur mbrenda dy javëve që isha larguar. Ua! Çfarë ndryshimi, vetëm mbrenda asaj kohe.

**Anna Di Lellio:** Cila ishte detyra jote më e madhe në Kosovë? Ose çka të kujtohet? Sa zgjati mandati yt?

**Christopher Dell:** Epo, i kalova atje 18 muaj. Supozohej të ishte një vit, por unë, gjatë kësaj, unë u propozova të bëhesha Ambasador në Angola, dhe nuk kisha nevojë të ikja mbrenda një viti në shkurt, kështu që unë mbeta gjatë gjithë verës. Kur e pata mundësinë të mirëprisja George Bush atje si President, unë, në një farë mënyre, u gjeta ndërmjet dy presidentëve.

Mendoj që gjëja e parë e madhe që më ka ndodhur, që të paktën mua më kujtohet tani ka qenë negociimi që të bëhet armëpushim në Luginën e Preshevës. Do të kujtoni që kishte ndodhur kjo lëvizje guerile në Preshevë dhe mbaj mend që shkoja në Gjakovë, dhe përsëri luajta njëfarë roli të ndërmjetësuesit me shqiptarët. Më është dashur të negocioj, për një lloj marrëveshje, midis shqiptarëve të Thaçit dhe shqiptarëve të Preshevës, për të provuar të kontrollojmë këtë dhe për t'i dhënë fund betejës. Por gjërat harrohan, unë i kam harruar të gjitha termat e diskutimit, por kjo është ajo që ndodhi. Dhe u emërua udhëheqësi i shqiptarëve të Preshevës, si quhej? Jonuz, ai përfundoi në burg më vonë.

**Anna Di Lellio:** Nuk më kujtohet, UÇPMB.

**Christopher Dell:** Më fal.

**Anna Di Lellio:** UÇPMB ka qenë...

**Christopher Dell:** UÇPMB, ishte organizata.

**Anna Di Lellio:** Dhe ndoshta ke qenë në Gjilan jo në Gjakovë.

**Christopher Dell:** Gjilan, më fal, më fal, Gjilan. E harrova edhe emrin, në Gjilan e kaluam një ditë të vështirë të negociatave me Thaçin i cili eventualisht i bindi ata që duhet ta bëjnë një armëpushim, që ata të mos hedhin zjarr. Dhe, natyrisht, ajo mbeti një situatë e brishtë shumë kohë më vonë dhe është akoma një temë, siç them një telenovelë, dua të them që këta skenarë vazhdojnë. Por armëpushimi kryesisht u mbajt, pati incidente të herëpashershme.

Më kujtohet kur shkuam për herë të parë te... mendoj që quhej OP-63, ku mund ta shihje Luginën e Preshevës, ku ushtria amerikane kishte krijuar një pikë vrojtimi. Dhe duke parë në dylbi, këtë rajon

shumë të trazuar. Dhe për habinë time, duke kuptuar se në distancë mund të shoh Bullgarinë, malet e Bullgarisë Perëndimore, tronditja për çfarë gjeografije të vogël po flasim, dua të them, ishte një linjë e drejtpërdrejtë, me siguri tridhjetë deri në dyzet kilometra më së shumti, e Serbisë Jugore në atë pikë, është shumë e ngushtë, mbase pak më e madhe se ajo, por sidoqoftë ju mund t'i shihnit malet e Bullgarisë.

**Anna Di Lellio:** Është si Lartësitë Golan.

**Christopher Dell:** Po, saktësisht, apo në fakt, të qenit në Maputo dhe të mos jesh në gjendje të shkosh në Afrikën e Jugut, gjë që mund ta bësh për dyzet e pesë minuta tani. Tjetër, gjëja që unë isha i kënaqur që mund ta bëja, me të drejtë apo jo, ishte të marrë merita për këtë. Në momentin e zgjedhjeve jugosllave në... kur ishte? Tetor 2000.

**Anna Di Lellio:** 2001.

**Christopher Dell:** Jo, duhet të ketë qenë 2000 sepse unë jam larguar deri atëherë.

**Anna Di Lellio:** 2000, po.

**Christopher Dell:** I merr udhëzimet nga Washington. KB-ja duhet të shkojë dhe t'i vëzhgojë këto zgjedhje, brenda Kosovës. Jo t'i vëzhgojmë në kuptimin e, e din, duke i vlerësuar ato ose duke qenë në vendet e votimit. Ne kemi dashur të sigurohemi, kemi dashur të dimë se sa njerëz paraqiten në vendet e votimit atë ditë. Sepse, ajo që të gjithë prisnin ishte që Millosheviqi do të pretendonte se kishte dyqind mijë vota në Kosovë dhe 98 përqind e kishin mbështetur atë dhe i vidhnin zgjedhjet në atë mënyrë. Dhe kështu qëllimi ishte që të mund të thoshim jo, ne e dimë se X numri i njerëzve hyri në vendvotimin atë ditë dhe X është më e ulët se dyqind mijë. Ne nuk e dimë se si votuan, nuk kemi ide, por vetëm ky është numri maksimal i votuesve që mund të kishte.

Dhe, duke shkuar me këto udhëzime, duke shkuar për ta parë Bernard Kouchner dhe duke i thënë, "Bernard, këtu është ajo që duhet të bësh për ne". Dhe, ishte, ishte vonë mbase, në zyrat e tij, atje poshtë në ndërtesën e qeverisë, dhe mbaj mend që ai e hapi një shishe Johnnie Walker Red, dhe ne u ulëm për të pirë uiski dhe unë mendoheja ta bind atë që KB-ja duhej të marrë këtë rol. E cila ishte, siç mund ta imagjinoni kontraverze, sepse ishte vendosja e KB-së në mes të një procesi politik. Jo të gjitha shtetet anëtare ishin mbështetëse të kësaj, por unë kisha zhvilluar një raport mjaft të mirë personal me Kouchner me kalimin e kohës. Kështu që unë ndjehem sikur ky takim me të vërtetë e bëri atë të thotë vetëm, "Po, është gjëja e duhur për të bërë dhe ne do të mbështesim atë".

Jock Covey, i cili ishte deputet dhe amerikan, më pas më tha që, vite më vonë më tha që, shumë prej stafit të tij ishin shumë rezistentë dhe ai në thelb u tha atyre që, “Shiko SHBA-ja është kontribuesi më i madh në KB, ata po paguajnë një të tretën e pagave tuaja, kjo është koha e shpagimit, ne do ta bëjmë këtë”, dhe ata e bënë. Dhe të gjithë sillëm, dhe unë shkova dhe pashë zgjedhjet po atë ditë, nga larg. Ata kishin njerëz që monitoronin çdo vendvotim, bukqualisht të ulur disa qindra metra larg duke shikuar me dylbi dhe duke numëruar numrin e njerëzve që ishin brenda dhe jashtë dyerve atë ditë.

Pra, përpara se të shpalosnin rezultatet e zgjedhjeve, mund të dilnim me një numër. Dhe besoj se numri ishte, nuk e mbaj mend tani. Mund të them që ishte njëzet mijë. Kishte njëzet mijë votues të mundshëm atë ditë nga Kosova. Dhe, natyrisht, kjo e ndaloi Millosheviqin të pretendonte se kishte fituar shumicë masive, pjesën dërrmuese dhe si rrjedhojë që kishte fituar zgjedhjet në tërësi.

**Anna Di Lellio:** E përmende gruan më herët, a e ke takuar në Bullgari?

**Christopher Dell:** Po, e takova në trajnime gjuhësore për Bullgarinë.

**Anna Di Lellio:** Në rregull.

**Christopher Dell:** Po ka qenë në... burri i saj i atëherëshëm kishte fituar një Fulbright për të ardhur në SHBA. Ajo ishte një nënë e re, që ndiqte shkollimin fillestar në Universitetin Amerikan, dhe Departamenti Bullgar për Shërbimet e Jashtme, kishte nevojë për një klasë më të madhe se ajo normale, ata kishin nevojë për një mësues shtesë. Kështu që ajo u punësua për tre muaj për të qenë mësuese e gjuhës Bullgare. Ishte puna e saj e parë profesionale në Amerikë. Tani ajo është vetë diplomate amerikane dhe po shërben në Pakistan me USAID.

Ne u takuam atëherë dhe pastaj qëndruam në kontakt vetëm në Bullgari sepse fëmijët tanë janë në të njëjtën moshë. Djali i saj ishte tre muaj më i madh se vajza ime, dhe kështu gjatë verës në Bullgari ata takoheshin dhe luanin, dhe unë u njoha me familjen dhe mbeta në kontakt. Por, kur shkova fillimisht në Kosovë dhe pastaj në Angola, ne kishim humbur kontakt për shumë vite derisa isha në Zimbabve dhe ne e rizbuluam njëri-tjetrin. Kur ne të dy ishim të divorcuar dhe kishim një jetë ndryshe dhe një gjë çon në një tjetër (qesh)...

**Anna Di Lellio:** Po, në fakt, pyetja ime është edhe rreth kësaj lloji jete... problematike për të mbajtur familje, po mendoj, nëse udhëton shumë, lëviz dhe ke një ndjenjë të...

**Christopher Dell:** Është shumë e vështirë për familjet. Sidomos në kohën moderne, e din, ku edhe bashkëshortet e kanë karrierën e vet. Dhe është shumë përçarëse për bashkëshortin që nuk është në



Shërbim të Jashtëm. E dini, ktheheni në Washington për disa vite, dhe çdo tre ose gjashtë vjet detyroheni të transferoheni në një vend tjetër. Çfarë i bën asaj karrierës së bashkëshortëve?

Departamenti i Shtetit ka luftuar me të vërtetë me këtë, dhe jo me shumë sukses. Pra, shumë ZSHJ martohen me zyrtarë të tjerë të Shërbimeve të Jashtme dhe pastaj përpiqen ta menaxhojnë karrierën. Ajo që funksionon shumë mirë për disa njerëz është se bashkëshortja i shoqëron, shpesh këto ditë ndodh që edhe bashkëshorti jo vetëm bashkëshortja. Megjithëse, historikisht gratë ishin ato që pritej të ndiqnin, karriera të pavarura. E dini, kam pasur një kolege në Mozambik, për shembull, herën e dytë, ajo ishte një dizajnere grafike. Me teknologji moderne, ajo mund të punote pothuajse kudo, por po, është një nga sfidat me të cilat përballen Shërbimet e Jashtme, dhe është e vështirë për familjet.

Të gjitha tingëllojnë shumë romantike dhe të këndshme, të ç'rrenjoseni çdo dy vjet, duke u marrë me lëvizjen, është një makth, pra situata të reja, miq të rinj, shefa të rinj, shkollë të re për fëmijët tuaj, nëse keni fëmijë. Njerëzit në SHBA vlerësojnë shumë sakrificën që bën ushtria jonë, dhe ata sigurisht sakrifikojnë, por Shërbimi i Jashtëm nuk është shumë larg për sa i përket ndikimit që ka kjo karrierë në familje. Shumicën e kohës nuk na dërgojnë në zona të luftës dhe ku na shtënë; por këto ditë, dhe kohët e fundit, ndodhë edhe kjo. Pra, po, është një sfidë e vërtetë. Por si çdo gjë tjetër, ka kompromise. Shpërblime të mrekullueshme në karrierë, keni mundësinë të shkoni në vende dhe të takoni njerëz që kurrë nuk do të keni ëndërruar që do t'i takoni. Asnjëherë nuk kam menduar të shkoj në Afrikë kur u bashkova me Shërbimin e Jashtëm, hapa një pjesë të tërë të botës për mua që nuk e prisja kurrë, por ka edhe një çmim.

**Anna Di Lellio:** Kur ke shkuar në Kosovë, ka qenë, vërtetë, vërtetë pas konfliktit...

**Christopher Dell:** Po.

**Anna Di Lellio:** Sepse lufta përfundoi disa muaj më parë. Si e krahason me ndonjë vend, për shembull me Mozambikun? Po mendoj ke qenë... a je ndjerë i sigurt, a je ndjerë më i sigurt?

**Christopher Dell:** Kur kam shkuar për herë të parë në Kosovë, ishte përvoja ime e parë ku kisha sigurim të detajuar. Ka qenë vendi i parë që kam jetuar ku kjo ishte e nevojshme, dhe këta ishin profesionistë të nivelit shumë të lartë. Njësia ushtarake që ka vazhduar të bëhet mjaft e famshme për arsye të tjera, por kurrë nuk u ndjeva, mbase për shkak të pranisë së tyre, nuk u ndjeva kurrë i pasigurt. Unë mendoj se ekzistonte rreziku i mundshëm që Millosheviqi mund të provonte të bënte diçka, e dini, kjo është arsyeja që ata ishin atje. Por, sa i përket popullit shqiptar, ata do të më mbronin shumë përpara se të vinin forcat e mia të sigurisë. Asnjëherë nuk u ndjeva i pasigurt në atë mënyrë. Ekzistonte një rrezik prej minave, mjetet e pashpërthyer dhe e gjithë kjo, kështu që ju e dinit se duhet të kishit

kujdes ku ecni dhe të dilni në livadhe të panjohura nuk ishte diçka shumë e këshillueshme. Jo, por në përgjithësi, më pëlqeu që nga fillimi. Ndihesha mirë duke qenë atje.

Ne ishim të mirëpritur, padyshim, ndjeja se puna ishte shpërblyese. Zoti e di se ishte sfiduese. Sidomos në fillim, ishte si të jetosh në këtë dhomë të vetme. Nuk dua ta shokoj audiencën tuaj me historinë e miut që ishte mbi mua, në shtratin tim tri herë mbrenda një nate, përfshirë edhe herën e fundit, në qafë. Kushtet ishin të rënda. Morra një mace, që e zgjidhi atë problem, e që ndërroi jetë këtë vit. Por, ishte e shkëlqyeshme, ishte emocionuese, ishte e rëndësishme, kishte përparësi dhe ishte qendra e vëmendjes së Washingtoni. Dua të them, kështu që për një diplomat profesional, në karrierë, nuk ishte vendi më i mirë për të qenë përkundër vështirësive personale për të jetuar në një vend si ai.

Por, ju e dini, kemi pasur energji elektrike, kemi pasur ujë, që ishte diçka që shumë prej popullsisë e kishte. Një nga çështjet e mëdha me të cilën ende po merreshim ishte përpjekja për të krijuar dhoma të ngrohta për njerëzit në mënyrë që ata të mund të mbijetojnë dimrin, atë dimrin e parë kur pati një ndarje të plotë të të gjitha sistemeve dhe shërbimeve. Kështu që nuk u ndjeva kurrë sikur kisha të drejtë të ankohesha, dua të them, e di, ishte një lloj si, ishte një lloj si të jetosh përsëri në një dhomë konvikti në kolegji, ndërsa njerëzit e tjerë po luftonin me situata shumë më të vështira. Dhe kështu ishte vërtetë e dobishme të kthehesh dhjetë vjet më vonë, njëmbëdhjetë vjet më vonë, dhe të shohësh rimëkëmbjen e vendit.

Mbaj mend që po dilja, perspektiva juaj vazhdon të ndryshojë, në një prej fshatrave atje në zonën e Dukagjinit, ku serbët kishin kaluar nëpër fshat dhe e kishin shkatërruar; gjithçka u dogj dhe u qëllua [me armë], u rrafshua edhe xhamia ishte shemb dhe minarja ishte rrënuar; dhe nuk kisha parë kurrë një shkatërrim të tillë më parë, por më pas u caktova në Angola ashtu siç thashë dhe pashë gjëra edhe më të këqija atje. Do të thotë qytete që kishin qenë vija e parë e frontit të luftës civile për njëzet vjet. Vendos gjithçka në Kosovë në një perspektivë paksa më ndryshe.

Kosova ishte shumë me fat që faza e luftës ishte e shkurtër aq sa ishte, dhe unë vetëm mund ta imagjinoj se si, sa më keq do të ishte sikur të kishin kaluar një apo dy vjet. Nuk do të kishte qenë vetëm një fshat, gjithçka do të ishte rrafshuar ashtu siç pashë në Angola më pas. E cila përsëri forcon besimin tim se ne bëmë gjënë e duhur, domethënë e kemi ndaluar para se të bëhej më keq se sa që ishte.

**Anna Di Lellio:** Pra prej Kosovës ke dalur në, prapë te... prej dimrit të vitit 2000, që më kujtohet shumë mirë, ke shkuar prapë në Afrikë?

**Christopher Dell:** Vjeshta e vitit 2001, po, apo natyrisht pranvera në disa hemisfera, por po tetori i vitit 2001. Po kështu unë u largova nga Kosova, kështu që George Bush erdhi për një vizitë dhe ne u takuam

në Bondsteel. Ai kaloi shumë pak orë në tokë. Ju kujtohet që ai u zgjodh në Ushtrinë amerikane, ushtria më e mirë në botë nuk bën ndërtimin e kombit, dhe Kosova ishte një projekt ndërtimi kombëtar. Kështu që ai nuk erdhi atje i bindur për të gjitha këto, kjo ishte lufta e paraardhësit të tij në fund të fundit.

**Anna Di Lellio:** Ke qenë në Kosovë gjatë 11 shtatorit.

**Christopher Dell:** Jo.

**Anna Di Lellio:** Jo.

**Christopher Dell:** Sapo u largova. Dua të them që kisha marrë disa javë pushim. Unë mora pushim një javë pas vizitës së Bush-it.

**Anna Di Lellio:** Në rregull.

**Christopher Dell:** U ktheva, e pata lejen. Jo, seancat e mia, të Senatit, më 11 shtator, ku unë isha atje, që me shaka e quaj kabinë e ambasadorëve. Në Departamentin e Shtetit, ku ata ju tregojnë se çfarë, ata përpiqen të sjellin njerëz në karrierë dhe të emëruar politikë dhe përpiqen t'i ndihmojnë të emëruarit politikë që ata të kuptojnë se në çka po hyjnë. Shumë prej tyre nuk kanë shërbim të mëparshëm qeveritar, dhe ne ishim ulur në një dhomë në Departamentin e Shtetit dhe të gjithë këta njerëz filluan të nxitonin brenda dhe jashtë, diçka po ndodhte.

Në pauzë, një nga instruktorët tonë tha, “Ka qenë një aeroplan, një aeroplan ka kaluar përmes|, a u goditKulla e Veriut e para? “Kulla e Veriut”, dhe në pushim ne e ndezëm TV-në. Duke bërë këtë avioni i dytë goditi kullën tjetër, dhe instruktorët thanë, “Jo, jo, nuk ka asnjë problem këtu, nëse ata do të ishin një kërcënim i vërtetë, DS, siguria diplomatike, do të na thoshte”. Unë iu drejtova një prej kolegëve të mi dhe thashë, “A di çka unë po iki nga këtu, sepse, mos mendoni, ja një mësim për ju Z. emëruesi politik, mos u mbështetni në DS për ta shpëtuar jetën”. (qesh), dhe ju e dini, disa minuta më vonë, sigurisht që avioni hyri në Pentagon. Mbaj mend, në atë moment, të gjithë po largoheshin nga Departamenti i Shtetit, ishte shumë e qartë se po ndodhte diçka e madhe.

Kështu që më kujtohet që po dilja në rrugë dhe dëgjoja shpërthime në sfond, duke parë kolonën e tymit që dilte nga Pentagoni dhe në ndërkohë Washingtoni ka qenë, dua të them se të gjithë po përpiqeshin të largoheshin nga qyteti. Një bllokim i madh trafiku, askush nuk mund të shkonte, unë po qëndroja në një vend afër, mund të ecja. Por më vonë atë pasdite, qyteti ishte, ishte i egër, unë dola për shëtitje dhe, po kërkoja një telefon me pagesë që të mund të telefonoja nënën time në New Jersey. Kjo

ishite para kohës kur kishte telefona celularë, por rrjeti i celularëve nuk funksiononte dhe sa tmerrësisht i heshtur ishte Washingtoni. Ishte një qytet fantazmë, ishte një ditë e çuditshme.

**Anna Di Lellio:** Dhe prej aty?

**Christopher Dell:** Në Angola.

**Anna Di Lellio:** Angola

**Christopher Dell:** Në Angola.

**Anna Di Lellio:** Që është një vend interesant?

**Christopher Dell:** Aty ku po zhvillohej një luftë tjetër civile afrikane. Jonas Savimbi<sup>11</sup> dhe UNITA<sup>12</sup> ishin akoma në fazat përmblyëse të luftës së tyre kundër qeverisë MPLA<sup>13</sup> në Ruanda. SHBA kishte një histori shumë më të komplikuar atje në Mozambik. Në Mozambik ne nuk e mbështetëm kurrë RENAMO, megjithëse Jesse Helms u përpoq të na tërhiqte në atë luftë ashtu si ishim të përfshirë në Angola. Departamenti i Shtetit gjithmonë rezistoi, dhe me shumë zgjuarsi publikoi një raport në fillim të viteve '90, Raporti Gersony, për mizoritë e RENAMO-s, i cili më pas i bëri të paprekshëm. Dhe kështu nuk u tërhoqëm kurrë. Por ne e kishim pasur këtë histori në Angolë, natyrisht, megjithëse deri në kohën kur kisha ardhur atje në vitin 2001, ne u distancuam nga UNITA për nëntë vjet. Për shkak se ata nuk i pranuan rezultatet e zgjedhjeve të '92-tës, u kthyen përsëri në luftë, ne i shkëputëm dhe u bë një lëvizje e vërtetë guerile në atë pikë.

Kështu që unë arrita atje në tetor të 2001-tës dhe lufta po vazhdonte, ju e dini se dukej shumë si Mozambiku në atë Luandën ishte disi i izoluar. Mënyra e vetme për të udhëtuar nëpër vend ishte fluturimi. Dhe pasi që ne po siguronim shumë ndihmë, shumë ushqim, kishim, ju e dini, një shërbim ajror, që mund t'i thërrisnim për të bërë udhëtime. Kështu që atëherë shkova në Huambo dhe pashë këtë qytet që ishte në front të luftës civile për vite e vite. Pra prej një rruge në rrugën tjetër përballë dhe kështu që të gjitha ndërtesat u goditën dhe u bombarduan.

<sup>11</sup> Jonas Malheiro Savimbi ishte një politikan revolucionar angolan dhe udhëheqës ushtarak që themeloi dhe drejtoi Bashkimin Kombëtar për Pavarësinë e plotë të Angolës (UNITA).

<sup>12</sup> Unioni Kombëtar për Pavarësinë e plotë të Angolës (UNITA) është partia e dytë më e madhe politike në Angola. E themeluar në vitin 1966, UNITA luftoi përkrah Lëvizjes Popullore për Çlirimin e Angolës në Luftën për Pavarësi (1961-1975) dhe më pas kundër MPLA në luftën civile që pasoi (1975-2002).

<sup>13</sup> Lëvizja Popullore për Çlirimin e Angolës, është një parti politike që ka sunduar Angolën që nga pavarësia e vendit nga Portugalia në vitin 1975.

Dhe pastaj në shkurt të 2002-tës, natyrisht, Savimbi vritet dhe UNITA ra pothuajse menjëherë. Dhe kishte shumë dyshime të ngushta në Washington se me të vërtetë ishte shkatërruar [UNITA] sepse kishte një numër njerëzish që kishin këto marrëdhënie të gjata, që e kishin të vështirë t'i linin, ta pranonin faktin që UNITA kishte ndaluar së funksionuari si lëvizje guerile, si parti rezistence. Dhe unë kam pasur mjaft tension me Departamentin e Shtetit në lidhje me këtë, duke thënë, “Njerëz ka përfunduar. Ju nuk e kuptoni, kjo nuk është marrëveshje e negociuar. Qeveria fitoi, UNITA është mposhtur”. Dhe të mbijetuarit nga UNITA, ata ishin duke jetuar me vite në provincat e largëta lindore të Angolës. Nuk kishte ushqim, ata po mbijetonin në mjaltë të egër që gjenin nëpër shkurre.

Është histori e famshme: Savimbi ishte ushqyer mirë, dhe në të vërtetë ai qëlloi kuzhinierin e tij sepse vodhi ushqim për vete. Një tjetër kuzhinier, pra, vdiq nga uria, më mirë se sa të rrezikonte të kapej duke vjedhur ushqim. Ata ishin në gjendje të dëshpëruar. Savimbi u largua dhe gjithçka kollapsoi. Atëherë e gjej veten duke bërë gjëra shumë të njohura, duke punuar me AID për të gjetur kupa kallaji dhe tenxhere dhe tigan dhe gjëra për forcimin e UNITA-së, të cilët po silleshin në... E harrova emrin tani, por ju e keni pasur këtë, por kampet e demobilizimit. Dhe më pas një nga drejtuesit e vjetër e Byros Afrikane kishte qëndruar dhe më tha, “O Zot Chris, ke qenë me të vërtetë në krye të gjërave, ke bërë një punë të mirë vetëm, pavarësisht nesh”. Ishte ky lloj i punës, duke u përpjekur për t'i bërë gjërat pa Washingtonin, duke kapërcyer rezistencën e Washingtonit.

Dhe filluan negociatat zyrtare të paqes, dhe përsëri ishte shumë e ngjashme si në Mozambik, midis palëve, e din, në Moz... e dini, në, në, në Angola ishte treshja, tri vendet që ishin kërkuar nga palët për t'u përfshirë ishte Portugalia, Shtetet e Bashkuara dhe në këtë pikë Rusia. Dhe kështu ne ishim tre partnerët ndërkombëtarë të ndërmjetësimit. Por në të vërtetë nuk funksionoi si Mozambiku sepse me të vërtetë ishte një përfundim tjetër, dhe UNITA gjysmë zemre po merrte pjesë në këtë proces dhe jo vërtetë duke bërë shumë përlëshje. Askush prej neve nuk mund të bënte diçka që ata të negocionjë më shumë, për të marrë më shumë, e din, për të marrë norma më demokratike të pranuar dhe për të lënë një fushë të nivelit të lojës për zgjedhjet e para.

Dhe pastaj një ditë i kishim thirrur në një mbledhje dhe ata bukqualisht nënshkruan dorëzimin. Ata thjesht dhanë gjithçka, dhe unë u zemërova, unë e thirra me emrin ishte... emrin e luftës e kishte Gotu, dhe e harrova emrin e tij të vërtetë tani. Të gjithë, të gjithë në Angola kanë një emër lufte, ai ishte Gotu, ai ishte udhëheqësi i mbijetuar i UNITA-s. Dhe ai erdhi në zyrën time dhe ai po shikonte në tokë këpucët e tij. Unë i thashë, “E kam një pyetje, sa kushton ti?” Ai disi shikoi edhe më thellësisht këpucët.

E vërteta është se qeveria e Angolës bleu paqen. Megjithatë nuk ishte një rezultat demokratik, ai nuk ndërtoi norma demokratike në sistem, masat e tij mbrojtëse dhe gjërat që ne të gjithë shpresonim të

shohim si rezultat. E vërteta është se ishte një fund më i prerë për luftën e tyre sesa ai në Mozambik. Ata i paguan me paranjerëzit e UNITA-s. U dhanë shtëpi dhe makina dhe trajtim mjekësor, Gotu ishte mirënjohës ndaj qeverisë sepse ishte duke vdekur për bukë. Ata e kishin, unë e dërgova atë në Afrikën e Jugut dhe, e dini, u kujdesëm për të për gjashtë muaj dhe e ushqyem, e dini, regjim ushqyese, sa për të mbijetuar.

José Eduardo Dos Santos, çfarëdo faje që kishte si lider, e kuptoi që ai kishte burime për të siguruar paqe të qëndrueshme në Angola, dhe ai e bëri. Ai nuk ka udhëhequr llojin e qeverisë demokratike që dëshironim, por vendi kurrë nuk shikoi mbrapa; dhe po, nuk ka pasur asnjëherë asnjë shenjë se lufta do të rishfaqej në Angolë ashtu siç pati vazhdimësi të djegjes së thëngjillit të Mozambikut prej asaj dite deri sot, 24 vjet më vonë, gati çerek shekulli më vonë. Pra, rezultate shumë të ndryshme.

Prapë turmat ndërkombëtare po vraponin përreth, procesi i paqes dhe pajtimit, sepse ne kishim vetëm peshkopin Tutu që bënte pajtime në Afrikën e Jugut, kështu që kjo ishte shija e ditës. Dhe përsëri angolezët nuk donin të ishin pjesë e saj, dhe dua të them angolanët e zakonshëm, shumica e angolanëve të thjeshtë thjesht donin që ajo të mbaronte dhe të harrohej, dhe të vazhdonin më tej, dhe t'i i bënin përpjekjet e tyre dhe ne t'i bënim përpjekjet tona që t'ju ndihmojmë të kthehen në këmbët e tyre dhe ta rindërtojnë jetën e tyre, në vend që të zgjidhnin rezultatet se kush i bëri çfarë kujt.

Pra, kjo ishte Angola, ishte një kohë mjaft emocionuese sepse me të vërtetë pamë që filloi rimëkëmbja dhe njerëzit dilnin nga shkurret në gjendje të tmerrshme. Dhe më pëlqen të bëj fotografi si hobi, dhe nga fotot më shqetësuese që kam bërë ndonjëherë janë të këtyre njerëzve, njerëz të dobët, që vijnë, dalin nga shkurret në malësitë qendrore të, të Angolës. Dhe një fotografi ishte shumë, të ndikonte, ishte një grua e shtrirë me kokën në prehrin e vajzës së saj dhe vajza ia largonte thërrijat nga flokët, sepse kjo është e gjitha, shihej qartë që nëna po vdiste nga uria dhe gjithçka që mund të bënte vajza ishte të përpiqej ta ndihmonte që t'ia heq morrat nga flokët e saj. Ajo grua me siguri ka vdekur disa orë më vonë, ishte tepër vonë edhe për ushqyerje terapeutike.

Një tjetër fotografi e një plaku të veshur me lecka që kanë marr ngjyrën e tokës, ngjyrë e verdhë e të kuqërremtë, mblidhte kokrra të rëna misri. Kishte një shpërndarje të ushqimit, ju e dini, misri amerikan shpërndahet nga Programi Botëror i Ushqimit, dhe ky njeri ka ardhur vonë ose nuk kualifikohet në një farë mënyre, ishte ulur duke marrur individualisht kokrra misri nga toka. Vendi kishte arritur në këtë pikë. Ndërkohë natyrisht, diamantet dhe vaji po i bënin njerëzit në Luanda mjaft të pasur.

Dhe një nga mësimet e mia prej kësaj ishte pasojat e paqëllimta të ndërhyrjes me qëllim të mirë, që vlen edhe për Kosovën. Por njëra prej tyre ishte, mbi dyzet vjet luftë civile, së pari, lufta koloniale, por kryesisht lufta civile. Njëzet vjet luftë civile, qeveria në Luandë, mësimi që ata kishin tërhequr ishte, pra mirëqenia e atyre njerëzve në brendësi, ku vepronin guerilët, “Ata nuk janë problemi jonë, domethënë ndërkombëtarët le të merren me ta”. Tani kjo pasqyron tensione etnike në vend, por ka pasur mungesë të përkushtimit të vërtetë për të bërë ndonjë gjë për t’i ndihmuar këta njerëz të dëshpëruar,; dhe kjo mbetet një sfidë për njerëzit e Angolës, edhe sot e kësaj dite, mendoj, edhe pse pastaj nuk kam kaluar shumë kohë atje, kur e shihni që Luanda u bë qytet kanceroz, jashtëzakonisht i madh, ku shumë njerëz po shkojnë sepse atje ka ende ngjarje që po ndodhin, edhe pse është jeta e dëshpëruar dhe jetojnë në kushte të tmerrshme, megjithatë është më mirë atje sesa në fshat, ku gjërat ende po mundohen të rimëkëmben.

## Pjesa e Tretë

**Anna Di Lellio:** Sa liri veprimi keni ju si ambasador nga Washingtoni, kur nuk jeni dakord me politikat? Dhe gjithashtu sepse, ti i di gjërat më mirë duke qenë atje?

**Christopher Dell:** Kjo është një nga truket e vërteta, mendoj, të tregtisë dhe nuk ka asnjë përgjigje. Unë mendoj se shkon, varet nga koha dhe vendi. Në disa vende, ju e dini, dua të them Madeleine Albright, nuk më ka ndodhur mua, por kur Larry Rossin shkoi për herë të parë në Kosovë, dhe Madeleine Albright, Sekretarja e Shtetit fliste me të në telefon gjashtë herë në ditë, duke përfshirë tri në mes të natës. Ai mezi mund të merrte frymë. Kam punuar gjithmonë për të krijuar pak hapësirë dhe jam munduar të krijoj më shumë liri veprimi. Një nga gjërat që kam mësuar nga Ambasadori Boland, i cili është më afër sa çdokush në Amerikë të jetë pjesë e aristokracisë sonë natyrore, dua të them që ajo vjen nga një familje e Shërbimit të Huaj me një trashëgimi të madhe, dhe ajo e dinte atë, ajo e dinte rolin e saj dhe i dinte të drejtat e saj si dhe përgjegjësitë e saj, dhe ajo veprroi në përputhje me rrethanat.

Dhe unë mendoj se nëse veproni në atë mënyrë krijoni pak hapësirë për veten tuaj. Por ju duhet të dini se si të jeni të zgjuar, si t’i tregoni Washingtonit atë që duhet të dinë dhe jo t’u tregoni atyre diçka që nuk duhet të dinë. Përsëri, kjo varet nga sa është në fokus, sa më pak që vendi është në fokus, aq më shumë keni liri veprimi natyrshëm. Dhe ka pasur një dallim të madh midis herës time të parë dhe të dytë në Kosovë. Por sinqerisht, unë do t’ju them këtë, perceptimi në Washington ishte, në disa qarqe në Washington, isha shumë i pavarur kur isha në Kosovë për herë të dytë. Nuk isha duke e përkulur

vijën, pavarësisht nga linja, nuk ishte kurrë e qartë për mua, sepse njerëzit nuk po i kushtonin vëmendje.

**Anna Di Lellio:** Ka qenë ndryshe në 2000-tën.

**Christopher Dell:** Ka qenë ndryshe në 2000-tën, kur ata po i kushtonin vëmendje të madhe. Deri në vitin 2009, ishte lajm i parëndësishëm, ju e dini, parada ishte zhvendosur në Washington. Mendoj se është më e vërtetë se kurrë. Kosova ishte disi {lëviz dorën e djathtë}, i gjithë rajoni kishte më pak vëmendje për momentin. Washingtoni reagon për krizën e ditës dhe titujt e gazetave. Është situatë e lajmit të mirë dhe lajmit të keq, Kosova nuk është titull kryesor sot, kështu që nuk do të tërheq shumë vëmendje. Është një lajm i mirë që nuk është në tituj, në përgjithësi. Dhe kështu që kjo është njëfarë lloj arti e jo shkencë. Është reputacioni juaj, është besimi që njerëzit kanë tek ju, është çështja nëse ju po e bëni atë siç duhet. Dua të them nëse veproni në mënyrë të pavarur dhe bëni gabime so të tërheqni vëmendjen e tyre shumë shpejtë lidhur me këtë. Por ndodh që jeni duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe duke i bërë gjërat e duhura dhe rezulton mirë, edhe pse Washingtoni mund të mos ketë menduar se ishte gjëja e duhur për të bërë në fillim; suksesi ndërtohet mbi suksesin. Dhe prandaj them se është një lloj arti, është praktikë e diplomacisë me kapitalin tënd, aq sa diplomacia me kapitalin e të tjerëve. Po pra, kështu...

**Anna Di Lellio:** Pra pas... a ka qenë Angola sukses për ty?

**Christopher Dell:** Unë...

**Anna Di Lellio:** Në karrierën tënde?

**Christopher Dell:** Po, sa i përket karrierës, po. Dua të them që më është ofruar një Ambasadë tjetër për të shkuar pas kësaj, për të shkuar në Zimbabve.

**Anna Di Lellio:** Gjë që ishte e rëndësishme.

**Christopher Dell:** Që ishte në qendër të vëmendjes në Washington në atë pikë, sepse gjërat me Mugabe ishin nxehur dhe fermerët e bardhë u larguan nga toka e tyre, jashtë fermave të tyre, ishte një çështje e madhe. Në përgjithësi, e konsideruar si një nga postet më të rëndësishme, Angola nuk është konsideruar kurrë si veçanërisht e favorshme nga Washingtoni. Unë mendoj se e gjithë bota që flet gjuhën portugeze vuan nga kjo pak, thjesht sepse nuk ka aq shumë folës dhe ekspert portugez, dhe kështu që anashkalohet pak. Unë mendoj se kjo është e vërtetë për Mozambikun sot, për shembull, edhe pse këto zbulime masive të gazit në det të hapur, dua të them strategjikisht do të jenë shumë të



rëndësishme shumë shpejt. Por Zimbabve u konsiderua një vend i madh i rëndësishëm. Ishte një shenjë nderi, të them ashtu, që më kërkuan të shkoja atje.

Dhe roli i Ambasadorit Amerikan atje, ndryshe nga Angola ku isha një pjesë e procesit, ne po mundoheshim të zhvillonim marrëdhënie më të mira me qeverinë, kemi punuar me të vërtetë shumë në të. Ju e dini, unë kam qenë një nga njerëzit që nënshkrova finalen, e quaj atë traktat paqeje, zgjidhjen përfundimtare të luftës në Angola, si dëshmitar i saj dhe ceremonisë zyrtare. Pra ne kishim shumë, pak a shumë, jo ngrohtë, sepse Angolanë historikisht kishin dyshime për ne për arsye të dukshme, që kishim mbështetur UNITA-n gjatë atyre viteve. Por sigurisht, një marrëdhënie në përmirësim, vendi varej nga aftësitë e kompanive amerikane të naftës që po prodhonin këtë pasuri nga e cila përfitonte vendi.

Në Zimbabve, ai ishte një rol krejtësisht tjetër. Roli im ka qenë të jem armiku publik numër një. Mugabe ishte duke shtypur opozitën, duke shtypur popullin e tij, duke marrë ferat në emër të të drejtës historike, ju e dini, padrejtësia raciale, mjaft e drejtë. Por ekonomia po shkatërrohej sepse fermerët nuk po mbaheshin, sistemi i ujitjes në të cilin ata mbështeteshin për të prodhuar në një vend të thatë. Kështu që njerëzit që vuanin ishin popullata me shumicë e zezë e Zimbabves. Kështu që roli im ishte që vërtet të mbështesja kritikën e opozitës për Mugaben dhe unë bëra vetëm një takim me të në tre vjet, kur paraqita kredencialet e mia. Dua të them që të gjithë u thirrëm në aeroport, sa herë që duhej të shkonim të shtrëngonim ia dorën dhe, por nuk kisha çfarë t'i thoja dhe ai nuk kishte çfarë të më thoshte, kështu që unë kurrë nuk kërkova një takim tjetër me të.

Pavarësisht kësaj, unë kisha mbajtur një profil relativisht të ulët. Nuk isha duke u përpjekur të isha agresiv ose pohues publikisht për rreth një viti. Pastaj, rreth një viti më vonë, ata erdhën pas meje publikisht Me një skenar qesharak, ku kisha shkuar, ishte në tetor, mbaj mend që ishte fundjava e festës për Ditën e Kolombit dhe ekziston një kopsht botanik në mes të Harare, dhe një mik i imi më kishte thënë për një lloj zog që të shkoj ta shikoj atje. Kishte gjoks të zbehtë blu, sa herë që e tregoj këtë histori gjithmonë e harroj emrin e zogut, mund të jetë, kjo do të tingëllojë tmerrshëm, mund të ketë qenë tit me gjoks të kaltër por kam harruar tani (qesh). Po, e di.

Sidoqoftë e pashë zogun dhe po ecja përreth këtij parku dhe e gjeta vetën në mes të një instalimi anti-ajror të pashënjuar. Ishin vendosur këto armë antike Pom-Pom<sup>14</sup> për të mbrojtur pallatin presidencial, i cili ishte aty pranë, kundër, nuk e di, sulmit nga Afrika e Jugut, nuk e di. Kështu që ata më arrestuan për rreth një orë, derisa sa u sqaruam, kupton? E di.. Çfarë po bëja atje? Kujt po i bëja

<sup>14</sup> Armë britanike, zyrtarisht e dizajnuar si QF 2-pounder, emri Pom-Pom i së cilës ka ardhur nga zhurma që e lëshon pas shpërthimit.

fotografi? A ishin sekrete të thella të shtetit, apo jo? Rreshteri që më ndaloi së pari më duhej të më kalonte te togeri, te kapiteni, dhe në fund shkova te Koloneli i Gardës së Presidencës. Ata më shoqëruan në Pallat për të parë kolonelin e rojes presidenciale, dhe ai kërkoi falje. Tha, “Oh më vjen keq, ju lutem mos e merrni këtë me të keq. Ishte e gjitha një keqkuptim, a ta ekzekutojmë dikë me varje për ty?” Unë thashë, “Jo (qesh), nuk është e nevojshme, nuk ka dëm, nuk ka asnjë gabim”.

Dy ditë më vonë, isha përsëri në Angola, për inaugurimin e Ambasadës së re, dhe titulli del se “Dell Arrestohet për Spiunazh ndaj Qeverisë së Zimbabve”. Prej aty tregimi u zhvillua, ose unë isha duke kërkuar seks homoseksual nëpër sgkurre ose ishe duke kërkuar prostitutat e reja që punonin nëpër shkurre ose spiunoja. Kjo vazhdoi për një javë. Ishte thjesht gjëra të pakuptimta. Mirë, kjo do të jetë loja që do po e luajmë. Unë dhashë një fjalim në pjesën lindore të vendit, në Mutare në Universitetin Amerikan. Ishte një fjalim shumë i thatë akademik, në të cilin në thelb citova hulumtimin e këtij akademiku amerikan i cili thoshte se justifikimet e qeverisë për jo zhvillimin e ekonomisë bujqësore janë të pakuptimta. Këtu janë të dhënat që tregojnë se më parë kur kishte thatësira, prodhimi në Mozambik [Zimbabve] në të fakt rritej, sepse sistemet e ujitjes ishin të mirëmbajtura dhe funksionale. Pra, kollapsi i ekonomisë nuk kishte asnjë lidhje me sanksionet ose thatësirën ose ndonjë justifikim tjetër, është politikë e dështuar e qeverisë.

Kjo shkaktoi, do të mendoje që është një temë mjaft e thatë, por trazirë të madhe dhe tituj të mëdhenj. E preferuara ime është, dhe nuk është rikthyer akoma nga Mozambiku, e kam futur në kornizë, ishte në faqen e parë të *The Daily Herald*, gazeta qeveritare, “Presidenti Thotë se Dell Mund të Shkojë në Ferr”. (qesh) Kështu që unë e mbaja atë me krenari në zyrën time gjatë gjithë pjesës tjetër të mandatit tim në Zimbabve, mendoj se edhe në Kosovë, kur u ktheva dikur. Ende është një prej krenarive të mia, është si të jesh në listën e armiqve të Nixon, e di, të jesh në listën e armiqve të Mugabes.

Që nga ajo pikë, ajo ishte një lloj lufte e hapur. Unë shpejt e kuptova se ata kishin më shumë frikë nga unë se sa unë prej tyre. Shumë vende vuajnë nga kjo sindromë që mendojnë ato janë qendra e universit dhe shqetësimi kryesor i politikës së jashtme amerikane. Dhe presidenti, Mugabe, me të vërtetë besoi se Shtetet e Bashkuara mund të dërgojnë marinsat ose diçka, e di. Kjo nuk do të ndodhte kurrë, por për sa kohë që ata besonin ashtu unë e dija se kisha shumë hapsirë, pra po kthehem te ajo pyetja juaj tjetër, për atë që mund të them dhe të bëj publikisht. Dhe nuk po e bëja vetëm për ta bërë, nuk ishte vetëm argëtim dhe lojëra. Qëlimi im në një kohë të zymtë për mozambikasit që nuk kërkuan, ndiheshin të pashpresë.

Ekonomia po shembej, dua të them që inflacioni arriti një milion përqind në vit. E dini, dua të them, unë u dhuroja miqve kartëmonedha të Zimbabvesë të njëqind mijë dollarëve për të ndezur duhan,

sepse nuk vlenin as një gjysmë qindarkë. Dhe së shpejti numrat shkuan në banknota një trilionë dollarëshe, pra, nuk mund as t'i numërosh zerot tek triloni. Ishte për t'i ofruar njerëzve shpresë, që dikush të ngrihej në këmbë dhe të thoshte jo. Dikush mund ta shtyente përsëri Mugaben kur askush tjetër nuk mundej. Udhëheqësi i opozitës u rrah dhe u fut në burg dhe e kishim lënë aty për të vdekur për disa ditë dhe unë, natën që ai u burgos, unë shkova rreth e rrotull burgut me Ambasadorin Britanik duke e kërkuar atë, vetëm sa për t'ju bërë me dije atyre që jemi aty. Kjo ishte situata. Dhe përsëri, nuk ishte vetëm sa për ta frikësuar. Ishte për t'u treguar njerëzve se ata nuk janë të gjithëfuqishëm, se ekziston një shkëndijë e vogël shprese atje.

Unë do të thoja se çfarë kam mësuar ishte limiti, limiti i asaj çfarë Ambasadori mund të bëjë vetë. Në të vërtetë nuk kam pasur shumë mbështetje në Washington. Condi Rice ishte Sekretarja e Shtetit. Ju kujtohet që ka qenë epoka e *Axis of Evil* [Boshtit të së Keqes], pastaj... cili ishte, cili ishte termi tjetër që kishin, përcaktuar... trilogjinë e vendeve jo demokratike që ishin Irani, Venezuela, dhe Zimbabve. Kjo ishte në një nga fjalimet e saj, kishte një frazë për këto, nuk ishte Boshti i së Keqes, por, do të dëshiroja të më kujtohej tani. Gjërat e rëndësishme harrohen dhe unë isha, unë shkruajta një mesazh duke i thënë, "Në rregull, frutat të varura më poshtë në këtë listë, më së lehti për t'u marrë vesh me ta ishin Koreja e Veriut, Irani, Venezuela dhe Zimbabve".

Në atë listë vendi që është më i ndjeshëm dhe më i brishtë, ku ne mund të bënim një ndryshim ishte Zimbabve. Nuk pata mbështetje. Në thelb një fjalim politikash çdo pesë muaj ose katër muaj duke thënë, "Mugabe është i keq", ishte gjithçka çfarë Washingtoni dëshironte të investonte në Zimbabve. Dhe unë shpejt kuptova se nuk mund të bëjë më shumë pa ndihmë. Dhe, e di, unë u largova nga atje dhe situata nuk ndryshoi. Nuk ka ndryshuar ende. Pavarësisht ndryshimeve ka mbetur njejtë. Ju e dini që ende ka një rrugë të gjatë për të vazhduar.

**Anna Di Lellio:** Dhe posti ishte...

**Christopher Dell:** Dhe pastaj një tjetër përmbysje e roleve për të shkuar në Afganistan, ku ne ishim miqtë më të mirë ndonjëherë të qeverisë.

**Anna Di Lellio:** Për disa.

**Christopher Dell:** Për disa, për qeverinë. Epo, ju e dini, fillimisht për qeverinë, edhe pse, Hamid Karzai ishte një njeri kompleks dhe gjithnjë e më i vështirë për t'u marrë me të dy vitet që isha atje. Ai përfundoi duke i parë Shtetet e Bashkuara, jo si zgjidhje, por si pjesë e problemit, dhe unë mund ta kuptoja se nga po vinte ai, atë këndvështrim. Përsëri kthehem në përvojën time në Angola, pasojat e padëshiruara të ndërhyrjes afatgjatë, e dini, ndonjëherë shkoni në drejtim që nuk e parashikoni dhe

nuk e prisni. Mund flasim për Afganistanin për orë të tëra. Problem i madh kompleks, vend i madh kompleks.

**Anna Di Lellio:** A ke bërë diçka? Që mund të thuash, këtë e kam bërë në Afganistan?

**Christopher Dell:** (Bënë pauzë të gjatë) Unë besoj se programi ynë i ndihmave atje ka bërë shumë të mira. Ne i përmendëm këto statistika gjatë gjithë kohës, por në shtator të vitit 2001 Afganistani kishte rreth shtatëdhjetë linja telefonike në botën e jashtme. Kur isha atje, në atë pikë, dhjetë ose njëzet afganë kishin telefona celularë, pra lidhje me botën. Por kjo është disi në rregull, ju mund të argumentoni nëse kjo bën ndonjë ndryshim, unë mendoj se arsimi për vajza, ku ato ishin privuar nga arsimi. Dhe tani ka një gjeneratë vajzash afgane, shumë prej të cilave tani janë gra, të cilat kanë marrë një arsim të mirë, mendoj se kjo është diçka për të cilën mund të krenohesh. Aty ku përpjekjet tona nuk kanë qenë të plota në Afganistan, mendoj se mësimi i kësaj zbritet në kufijtë e kulturës së vetë njeriut për t'u marrë me një kulturë të huaj.

**Anna Di Lellio:** Po, por a mund të ma japësh një shembull që ka të bëjë me ty? Çfarë ke bërë apo...

**Christopher Dell:** Në rregull.

**Anna Di Lellio:** Për shembull, ndryshimi kulturor ose ai në Afganistan që keni pësuar atëherë, apo në Portugali apo Kosovë?

**Christopher Dell:** Në rregull, po, në fillim të vitit 2009, pas Inaugurimit të Obamës, e dini, George Bush kishte një marrëdhënie shumë të afërt me Hamid Karzai, dhe kjo ishte një nga pikat e forta të politikave tona, ishte mënyra si mund të merreshin me njëri-tjetrin (kollitet). Unë ndoshta duhet ta kisha vënë këtë në procesverbal. Do ta bëj. Kthehemi në kohën kur Obama ishte kandidat. Jo, po ju them tani. Pra, Obama, ju kujtohet udhëtimin që bëri Obama në korrik të vitit 2008, ai shkoi në Afganistan dhe më pas në Berlin, ku mbajti fjalimin e madh dhe u prit me adhurimin e turmës së dyqind mijë njerëzve. Senatori Obama erdhi në Kabul dhe patëm një takim me Karzain, i cili nuk ishte i ngrohtë. Shihej që ata nuk e njihnin njëri-tjetrin, po mundoheshin ta kuptonin njëri-tjetrin. Dua të them, në atë pikë ishte mjaft e qartë se Obama do të ishte kandidati demokrat, kështu që ai ishte njëri prej dy burrave që ka të ngjarë të jetë presidenti i ardhshëm, kështu që Karzai kishte një interesim të madh për ta kuptuar atë dhe anasjelltas.

Pasi mbledhja përfundoi, Karzai e merr atë për një shëtitje nëpër oborrin e pallatit të vjetër mbretëror, ku ishte vendosur Presidenca në këtë kopsht. Pra, është një shans për ata që të bisedojnë pak më shumë sy më sy. Sigurisht, kishte një entuzazh të të gjithë atyre që i përcillnin dhe unë isha aty dhe të

gjitha mediat perëndimore e amerikane ishin aty. Dhe në fund të kësaj shëtitje të vogël rreth kopshteve, Karzai kthehet t'i thotë lamtumirë Senatorit Obama dhe i dhuron një kapelë Astrakhan, e cila është një mall luksoz atje, ju e dini, është bërë nga lëkura e një qengji të palindur, dhe është një objekt prestigji. Disi vetëm ata, disi, të klasit të lartë i veshin, ata që mund t'i blejnë, dhe Obama, i cili qartësisht dukej nervoz, thotë, "Oh faleminderit shumë!"

Dhe ai përpiqet t'ia dorëzojë ndihmësit të tij, dhe Karzai tha, "Jo, jo, jo, duhet ta provosh". Dhe ju e shihni Barack Hussein Obaman duke e menduar, "Nuk ka asnjë mënyrë që mbi tokë të gjelbër të Zotit që unë do e vë një kapelë muslimane para mediave amerikane." Apo jo? "Do të ishte fundi i fushatës sime". Dhe ky ishte momenti kur marrëdhëniet e tyre nuk u rimëkëmbën kurrë më. Karzai u ofendua thellë që Obama nuk e mirëpriti këtë dhe nuk e provoi kapelën. Obama mendonte me vete, "Pse u përpjeke të më bëjsh këtë befasi para gjithë botës, dhe të mundohesh të ma goditësh fushatën?" Asnjëri prej tyre nuk synonte këtë {bashkon shuplakat e duarve} qartësisht marrëdhënia e tyre (kollitet) nuk e mori vetën asnjëherë nga ai moment dhe nuk ishte kurrë e ngrohtë apo e ngushtë, ashtu siç kishte qenë me, me Bushin ose ta ketë mirëkuptimin.

Pra, në shkurt të 2009-tës, vendimi i parë i madh i politikës së jashtme të Obamës, me sa duket kundër instinkteve të tij, por e lejoi veten të bindet se ka pasur një mini-rritje. Ai dërgoi shtesë tridhjetë mijë trupa amerikanë në Afganistan. Ndërkohë, ka zgjedhje që janë në sfond. Karzai duhej t'i organizonte zgjedhjet, ai nuk mendohej që do të duhej të kandidonte dhe të fitonte përsëri Presidencën. Dhe cili amerikan i madh shfaqet në skenë për të qëndruar në krye të të gjitha gjërave afgane? Richard Holbrooke i lartpërmenduri, i cili në këtë pikë ishte më i madh se vet jeta, sipas mendjes së tij të paktën, por qartazi i zhgënjyer që nuk ishte bërë sekretar i shtetit, qartazi në kërkim të një roli, qartazi duke kërkuar një moment të ngjashëm me atë të Dayton, ku ai do të jetë edhe një herë, i vetmi person që mund të negociojë përfundimin e një konflikti të gjatë. Dhe prapë ishte e tmerrshme të merresh me të.

Ambasadori nuk ishte në zyrë, unë isha në krye dhe duhej të bëheshin disa iniciativa për zgjedhjet. Unë isha duke darkuar me Kai Eide, Përfaqësuesin Special të KB, dhe Holbrooke më telefonoi gjatë darkës. Unë nuk i përgjigjem telefonit, dhe ai më bërtet mua, "Nuk po përgjigjesh kurrë në telefon kur po të thërras. Nuk më intereson ku je dhe çfarë po bën". Pra në thelb, ne po hynim në një marrëdhënie shumë konfliktuoze me Karzain, të cilin Holbrooke nuk dinte si ta trajtonte. Dick kishte vetëm një truk, ai do të të kapte për fytyrë, do të të hidhte në tokë dhe të shkel mbi ty derisa të dorëzohesh. Kjo funksionoi me një kriminel të Ballkanit siç ishte Millosheviqi. Kjo nuk funksionoi me Karzain. Karzai dikur më tha një gjë që mendoj se është shumë e thellë e që i shpjegoi të gjitha. Ai tha {ulë tonin e

zërit} “Ambasador Dell, politika në vendin tim është si të shkruash mbi ujë”. Dhe Holbrooke kurrë nuk mundi ta kap për fyti Karzain dhe ta hidhte në tokë, apo jo? Ai gjithnjë i largohej, si shkrimi mbi ujë.

Pra, këto ishin ditët e para dhe ishte e qartë që po shkonte keq. Karzai nuk reagoi siç e prisnim ne lidhur me zgjedhjet. Kështu që unë kërkova të shkoj ta takoj dhe i thashë, “Më lër të ta sqaroj z. President. Nuk e di nëse dikush ju ka thënë juve, por ju jeni problemi më i madh i Barack Obamas tani”. “Çfarë do të thuash, shoku im, Barack?” “Jo, jo, jo, ai mendon se ka rrezikuar shumë presidencën e tij duke rënë dakord ta rris numrin e ushtarëve amerikanë këtu dhe ai tani nuk është i sigurt se është gjëja e duhur për t’u bërë. Ai mendon se e ka vënë në bast presidencën e tij dhe prapëseprapë, ju nuk po i realizoni premtimet tuaja rreth zgjedhjeve”. Dhe ishte disi kështu, ai u ul përsëri në karrigen e tij dhe qëndroi në heshtje për një sekond, dhe tha, “Faleminderit që ma shpjegove, nuk e kuptoja”. Tani për të qenë i sigurtë, kjo nuk ka çuar në ndonjë sjellje më të mirë nga ana e tij. Dua të them që ai kishte interesat e tij për të ndjekur. Por unë mendoj se të paktën kjo e ndihmoi atë që të jetë më pak fyes. I qetësoi ujërat për një kohë. Në fund të fundit, zgjedhjet ishin të vështira dhe problematike dhe asgjë nuk do të ndryshonte këtë.

Në planin afatgjatë, mangësitë tona në Afganistan qartësojnë pozicionin tonë se ne nuk mund të merreshim me Afganistanin nën kushtet e tyre, përbrenda kushteve të tyre. Për shkak se mënyra se si Afganistani ishte udhëhequr historikisht, nuk do të shkoja aq larg për të thënë me sukses, sepse, ju e dini, është një nga vendet më të prapambetura në botë, ju e dini, historikisht, dhe në çdo aspekt. Por, Mbreti Pasun në thelb kishte një marrëdhënie me çdo udhëheqës në vend, deri te nënkryetari më i ulët i çdo fisi midis Pashtunëve dhe të gjithë të tjerëve. Dhe ishte një sistem shumë i thjeshtë shpërblimi dhe ndëshkimi. Nëse e bënit atë që pritej, shpërbleheshit. Nëse jo, atëherë dënoheshit. “Së pari, ne ju vrasim dhi dhe dele. Pastaj, ne vrasim gratë tuaja dhe pastaj ju vrasim juve”. Brutale por efektive.

Ajo që Hamid Karzai duhej të bënte që ai sistem të funksiononte ishin burimet për ta bërë atë të funksiononte. Ai kishte nevojë për të ecur nëpër para, dhe ne nuk mund t’ia jepnim atë. Ne mund t’i jepnim para vetëm për projekte, por pastaj prisnim llogari dhe raportim. Ju e dini, ne duam të shohim që për çdo qindarkë është dhënë llogari dhe që është ndërtuar shkolla për vajza dhe jo që paratë kanë përfunduar në xhepin e disa njerëzve sepse ishte e nevojshme ta mbajnë dikë në anën tonë për një javë. Dhe ne nuk mund të merreshim me Afganistanin në kushtet e tyre, dhe ata nuk mund të merreshin me neve nën kushtet tona. Ne jemi thjesht shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri, dhe kjo do ta bëjë gjithnjë e më të vështirë të kesh sukses atje. Deri më sot kemi pasur vështirësi.

Unë mendoj se kemi pasur më shumë rezultate në vitet e [udhëheqjes së] Bushit. Mendoj që kishte një lëvizje, edhe pse nuk e kishim gjysmën e ushtrisë, dhe ishim harruar në luftën e Irakut. Por ishte

gjithashtu tipike për Dick që, kur të viesh në krye, gjithçka që bëri paraardhësi ishte e kotë dhe e gabuar, dhe ju do të bënit të kundërtën. Njerëzit e Bushit i kishin provuar të gjitha këto gjëra, dhe nuk kishin funksionuar. Ata provuan gjëra të tjera. Holbrooke u kthye në grupin e parë të gabimeve dhe u përpoq t'i rizbuloj të gjitha këto gabime edhe një herë, dhe unë nuk mendoj se ai dha ndonjë rezultat më të mirë. Por kjo përfundoi me mëshirë paksa nën dy vjet, dhe unë mora detyrën të shkoj në Kosovë.

**Anna Di Lellio:** A kanë kërkuar të shkosh në Kosovë apo ta kanë caktuar?

**Christopher Dell:** Më 11 shtator 2009, isha në vend gjatë dy muajve, Zëvendës Sekretari i Shtetit Jon Negroponte erdhi për një vizitë dhe unë e shoqërova atë. Dhe ne po voziteshim përreth, mendoj në Jalalabad, me një automjet të blinduar. E kisha takuar në Angola kur ai ishte në KB si ambasadori ynë.

**Anna Di Lellio:** Ke qenë dy vite, jo dy muaj.

**Christopher Dell:** Jo, kam qenë dy vite aty. Dhe ne po voziteshim rreth e rrotull dhe ai po më pyet se çfarë kisha bërë unë para Angoles dhe Zimbabves, çfarë kisha bërë më parë. Dhe unë thashë, “Kam qenë, e dini, në Kosovë menjëherë pas luftës”. Ai tha, “Oh, a do të konsideronit të ktheheshit?” Unë thashë, “Po, menjëherë”. Ai tha, “U kry”. Kështu që unë e dija që nga ai moment që do të, që unë do të emërohesh për ambasador. Pas një viti e gjysmë, dy vjet, dhe kështu edhe ndodhi. Unë nuk u lajmrova vullnetar por sigurisht që shkova shumë me dëshirë. E shikoja si një lloj projekti të papërfunduar. Ishte diçka që unë kisha qenë i përfshirë që në fillim, dhe doja të kthehesha dhe më pas, dhe tani vend i pavarur.

Unë do të them një nga gjërat për të cilat jam krenar që i kam arritur në Afganistan, një vend ku kemi arritur një numër të kufizuar të gjërave, ishte të bindim Karzain ta njohë Kosovën. Dhe në thelb argumenti ishte, e dini, “Shtet islamik i ndihmuar nga NATO [shtrin duart], shtet islamik i ndihmuar nga NATO dhe Shtetet e Bashkuara [lëviz dorën nëpër trupin e tij], ju kaq na keni borxh!” Dhe, kështu, Afganistani ishte vendi i dytë që e njohu, unë mendoj se Hondurasi ishte i pari dhe pastaj Afganistani. Dallimi ishte çështje orësh dhe kohe... para nesh, para Shteteve të Bashkuara madje, por unë mendoj se ishte qëllimshëm. Ne nuk donim të ishim të parët për arsye optike.

**Anna Di Lellio:** Jo, a e ndjenit se e njihnit Kosovën më mirë se Afganistanin? Megjithëse, dua të them, kulturën, dua të them. Kur u ktheve a e ndjeve që, “OK, unë nuk do t'i kem të njëjtat probleme që i kisha me Karzain”.

**Christopher Dell:** Sakt ashtu, dua të them, sigurisht që jam ndier sikur i kam njohur lojtarët. Dua të them, është një vend më i vogël, kështu që është më e lehtë të mësosh shumë shpejt për të, sepse ka

thjesht më pak. Nuk po them që politika nuk është po aq komplekse, dhe historia po aq e thellë, por thjesht kishte më pak material. Por, edhe sepse në thelb ishin të njëjtët njerëz, të paktën në anën shqiptare, që isha marrë më parë. Udhëheqësi i vetëm shqiptar që nuk ishte më atje në vend, natyrisht, Ibrahim Rugova, i cili kishte ndërruar jetë. Presidenti Sejdiu ishte një emër të cilin nuk e kisha njohur më parë. Por, përndryshe Hashim Thaçi apo Ramush Haradinaj, të gjithë këta njerëz ishin individë me të cilët isha marrë më parë dhe i njihja mjaft mirë, dhe gjithmonë kisha pasur marrëdhënie të mira pune. Dhe çështjet, ndërsa ato kishin evoluar, ishin, ju e dini, kryesisht të njëjtat.

Po supozoj se ka pasur disa ndryshime në strukturën institucionale ndërkombëtare. Dua të them, ICO<sup>15</sup> ka ekzistuar, që natyrisht nuk ka qenë herën e kaluar dhe roli i KB ishte zvogëluar. Ishte një pamje e zbehtë e asaj që dikur kishte qenë atje për sa i përket ndikimit që kishin dhe pushtetit vendimmarrës, dhe për shkak të mënyrës se si kishte evoluar situata. Dhe ju e dini, nuk ishte si më parë kur PSSP<sup>16</sup> povendoste për të gjitha, tani ky nuk ishte realiteti kur u ktheva për herë të dytë. Por në anën shqiptare ishin kryesisht personazhet e njëjtë. Shumë prej personazheve të njëjtë ishin edhe te serbët, dua të them, Ivanoviq ishte akoma lojtar. Peshkopi Artemije, Ati Sava, të gjithë këta njerëz ishin akoma aty, individualisht që i kisha njohur që prej herës së parë. Rada Trajkoviq, megjithëse ishte bërë më pak aktive dhe më e marginalizuar.

Kishte një klasë të re të liderëve serbë, një grup të ri udhëheqësish serbë, të cilët dukeshin më të gatshëm të punonin me situatën që u ishte dorëzuar atyre, në interes të përpjekjes për të gjetur, e dini, një jetë më të mirë për komunitetet e tyre, më shumë liri për të marrë frymë. Njerëzit si Slobodan Petroviciq, pra ishte shumë e lehtë të kthehesha në të njëjtin vend, madje edhe restorantet ishin të njëjta, “Tiffany” (qesh) ishte aty ende, e dini, është mirë të ktheheni dhe t’i shihni vendet. Është gjithmonë bukur të kthehesh në një vend që ke qenë. Jo aq shpesh ke mundësinë të kthehesh dhe të vazhdosh të punosh aty.

**Anna Di Lellio:** Pra t’i i njihje personat, të gjithë këta liderët, i njihje personalisht mirë, por a e njihje edhe kulturën?

**Christopher Dell:** Po.

**Anna Di Lellio:** Apo vendin, njerëzit.

<sup>15</sup> *International Civilian Office (ICO)* - Zyra Ndërkombëtare Civile në Kosovë ishte emëruar nga Bashkimi Evropian si pjesë e planit të Ahtisarit. Kjo zyrë ishte autoriteti më lartë që interpretonte dhe implementonte planin.

<sup>16</sup> Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm është një ekspert i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për ta përfaqësuar atë në takimet me krerët e shteteve për çështje kritike të të drejtave të njeriut. Përfaqësuesit mund të kryejnë vizita në vend për të hetuar pretendimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut ose të veprojnë si negociatorë në emër të Kombeve të Bashkuara.



**Christopher Dell:** Po, po, e ndjeja, ndoshta po e gënjej veten por e ndjeja sikur i dija, e njihja vendin dhe njerëzit. Kam kuptuar, ju e dini, gjënë që shqiptarët gjithmonë... kodin. E dija historinë e gjakmarrjeve. Kam ditur për historinë e hasmërive, gjaqeve, historinë, fenë. Ndjeja që, prapë, çdo diplomat që mendon se ai, ajo shkon në një vend të huaj dhe e kupton në tërësi vendin e mashtron veten. Truku është që gjithmonë të kuptosh mjaftueshëm. Ju mund të mos shihni thellë në sipërfaqe, por duhet të jeni në gjendje të lexoni se çfarë po ndodh në sipërfaqe nga sinjalet që shfaqen mbi sipërfaqe, dhe të thoni, “Ok, kjo po ndodh duhet të jetë një tregues i kësaj”, pa qenë pjesë e atyre marrëveshje sekrete që ndodhin në prapavi. Dhe, e din, kush e njeh kend, kush çfarë i bëri çfarë kujt, lidhja e kujt është ajo, ju kurrë nuk do t’i kuptoni të gjitha këto.

Është qesharake që ky ishte një nga problemet tona në Afganistan, kur disa agjentë të famshëm britanikë shkuan të jetonin për njëzet vjet në një distrikt dhe unë e pashë këtë, ne kishim disa njerëz që bënë kërkime në arkivat britanike. Dhe një nga këta agjentë ishte larguar në vitet 1920 nga distrikti i tij në një nga provincat e Lindjes dhe ishin gjashtëdhjetë faqe të emrave të cilat ai po i paguante që ta ruanin paqen. Ky ishte vetëm një distrikt në një provincë. Ka rreth tridhjetë distrikte në një provincë, dhe rreth tridhjetë provinca, apo jo? Në qoftë se nuk jeni të gatshëm të investoni shumë më shumë se ç’bën qeveria amerikane për të kuptuar, ju kurrë nuk do t’i kuptoni në atë nivel. Dhe kosovarët shqiptarë e kuptojnë vendin e tyre në një mënyrë që ne nuk do të mundemi kurrë, pra truku është që të mësosh të lexosh mjaft mirë nga sipërfaqja çfarë po ndodh, edhe pse nuk keni qartësi dhe vizion të përsosur.

**Anna Di Lellio:** Çfarë marrëdhënie keni pasur me njerëzit? Sepse në Kosovë si Ambasador Amerikan, ishit shumë i dashur por edhe pak i frikshëm sepse kishit një fuqi të jashtëzakonshme. Ambasadori Amerikan është i huaji apo figura publike më me ndikim në Kosovë. Pra, si ndikoi kjo në marrëdhënien tuaj me njerëzit?

**Christopher Dell:** E dini, unë gjithmonë, unë gjithmonë kam kuptuar autoritetin që ka ardhur me pozicionin, dhe do të rikthehem te ajo pjesë pas pak. Në marrëdhëniet e mia individuale me kosovarët kam qenë... pavarësisht nëse kam pasur sukses apo jo, nuk mund të gjykoj unë, unë gjithmonë isha me vetëdije të hapur dhe modest. Nuk më pëlqen ta përdor atë fjalë, njerëzit e përdorin atë tepër, modest. Gjithmonë jam munduar të sillem me ta si njerëzit. Dhe e din, të gjithë më njihnin dhe shumë njerëz vinin tek unë në rrugë për të më thënë diçka. Unë gjithmonë përpiqesha t’u jepja kohë. Nëse do të donin të fotografoheshin pranoja gjithmonë.

Mbaj mend një familje, po largohesha, isha me një mik, një mik portugez që po e vizitonte vendin, ishte me motoçikletën e tij. Dhe po ecnim asaj rruge në Gjilan, ku janë të gjitha dyqanet e vjetra, jo Gjilani,

por Gjakova, ku u rindërtuan të gjitha ballinat e dyqaneve pas luftës, të gjitha dyqanet prej druri. Dhe ne po shëtisim nëpër këto rrugë dhe na afrohet një çift, njerëzit e mi më përkthenin. “A do t’ia preni flokët vajzës sonë? A do t’ia preni fijet e para të flokëve?” Pra, kjo është një pjesë e madhe e, {lëviz dorën në mënyrë rrethore}, kështu që po, unë u pajtova, e din. Jam munduar të sillem me njerëzit si njerëz, të jem gjithmonë miqësor dhe i hapur, gjithmonë të kem kohë për të biseduar me ta t’i dëgjoj tregimet e tyre dhe të mësoj diçka prej tyre. Sepse e dija që isha edhe *macher*<sup>17</sup> i madh atje i cili u kërkonte që do të realizonte gjëra. Dhe ky ishte një nga tensionet e vërteta në atë punë në Kosovë, e di që kam pasur vështirësi me këtë gjithë kohën. Kam frikë se edhe paraardhësit dhe pasardhësit e mi gjithashtu.

Amerika luan, në fakt Ambasadori Amerikan luan rolin e një prindi në Kosovë, apo jo. Detyra jonë është të ndihmojmë Kosovën të rritet si *Newborn* [i porsalinduri], siç u tha me shenjë të madhe, në një të rritur, të pavarur që bën rrugën e vet në botë. Dhe çdo kush që ka rritur një fëmijë e din që puna juaj është t’ia lëshoni dorën fëmijës dhe të mësohet të ecë vet, t’i bëjë ata hapat e parë. E dini, është gjithmonë në pyetje çështja se kur dhe sa shpejt i shtyni ata dhe sa larg shkoni, por në fund të fundit ata nuk do të jenë të suksesshëm në jetë nëse varen shumë nga ju. Prandaj, ju duhet t’i inkurajoni ata të ndërmarrin më shumë hapa vet.

Unë dikur thosha me shaka, vetëm se nuk ishte shaka në Kosovë, problemi ishte se të gjithë kur i lëshojë sikur vraponin të hidheshin prej dritares. Sapo ja u lëshon dorën fillojnë problemet dhe pastaj ata ktheheshin duke vrapuar drejt jush, e di ashtu, “Na shpëto, na shpëto! Gjeni zgjidhjen, na ndihmoni! A dini, vetëm ju mund ta arrini këtë dhe të na pajtoni të luajmë pa probleme së bashku”. Ata e thonë këtë, kjo ishte një luftë e vazhdueshme. Si të përgjigjesh dhe si t’i thuash, “Jo, këtë herë ju duhet ta bëni vetë”.

Dhe mund të ju kujtohet incidentin, ishte në fillim, kur u ktheva në vitin 2009. Po mendoj në nëntor të vitit 2009, dhjetor, ku Thaçi papritmas njofton një ditë se po shkatërron qeverinë e koalicionit. Dhe ishte në mbrëmje dhe telefoni fillon të cingëroj dhe Skënder Hyseni po më thërret, “Duhet të bisedoni me Thaçin, kjo është...” dhe unë thash, “Kjo është politikë e koalicionit nuk keni nevojë për mua për ta rregulluar këtë punë mes jush”. Unë në fakt refuzova të ndihmoja dhe më pas, ata e rregulluan atë. Dua të them, të gjithë menduan më mirë të nesërmen në mëngjes dhe nuk e prishën qeverinë për disa muaj të tjerë dhe gjërat vazhduan. Kur ata po demarkonin kufirin me Maqedoninë dhe, siç e dini, Fletcher Burton dhe diplomati amerikan, kishin bërë punë të Zotit, këto ishin diskutime shumë të hollësishme.

<sup>17</sup> Njeri i rëndësishëm në gjuhën Jidish.

Dua të them, në disa raste, bukvalisht centimetra territori midis Maqedonisë dhe Kosovës. Hartat dhe fshatrat e vjetra, duke i punuar të gjitha. Maqedonasit më në fund ranë dakord, qeveria pajtohet, dhe unë po vozisja diku afër Pejës dhe më telefonojnë. Harrova tani se kush më ka thirrur, “Të gjithë po presnim që parlamenti ta miratojë këtë dhe Presidenti nuk është këtu. “Si po mendoni Presidenti nuk është aty?” Thashë, “Sejdiu nuk është këtu”. Unë e telefonoj atë dhe i them, “Zoti President, çfarë po ndodhë?” “Oh, askush nuk më ka treguar”. “Z. President, ju duhet të shkoni në shkollë sot. Ju duhet të shkoni në klasë, dhe duhet të bëni çfarë keni për të bërë”. Kështu ishte.

Ishte më e vështirë se kaq sepse nuk e ndjeja se kisha partnerë të përkushtuar ndërkombëtarë, që kishim nevoj për ta për të pasur sukses, pra që vetëm e lartësoi rolin e amerikanëve në mënyrat që unë nuk doja të ndodhte, por nuk kisha fuqi ta ndaloja këtë sepse nuk kisha te kush të drejtohesha. Dhe në periodha të ndryshme, dhe në vende të ndryshme, njerëz të ndryshëm ishin më mbështetës ose më pak mbështetës. Por kurrë nuk ka qenë, ishte gjithmonë një sfidë të mbash atë koalicion të njerëzve të angazhuar që Kosova të ecë përpara.

**Anna Di Lellio:** Nuk kishte më kuptim?

**Christopher Dell:** Epo, kishte, kishte absolutisht. Por, ju e dini, Bashkimi Evropian kishte perspektivën e vet dhe grupin e tyre të çështjeve. *ICO* kishte perspektivën dhe çështjet e veta dhe të gjitha këto gjëra kaluan në mënyra shumë komplekse që kjo do të thotë se nuk kishte, kjo do të thotë se ishte e vështirë të mbash konsensus për rrugën përpara. Dhe pastaj u ndez çështja se çka do të ndodhë me veriun. Ky ishte problem shumëvjeçar, çfarë të bëhet me veriun. Por, në fillim, zbulova një grup të ri të serbëve, të cilët ishin të gatshëm të mbështesin ndryshimet që kishin ndodhur, në emër të kërkimit të një marrëveshje më të mirë nga komuniteti i tyre. Dhe, Zoti më faltë sepse nuk i mbaj mend detajet, kështu që zgjedhjet në vjeshtën e ‘09-tës, a ishte ‘09-ta, kur u mbajtën zgjedhjet komunale? Po, kështu besoj. Dhe unë i them drejtorit tim të ndihmës, duke marrë hua një faqe nga libri i Frank Carlucci, “Ne do të shkojmë dhe të harxhojmë para në ato komunitete serbe dhe t’u tregojmë atyre se shteti i Kosovës ka vlerë”.

Kosha plehrash, grumbullimi i plehrave, vendosja e koshave të plehrave, të cilat nuk i kishin, plehrat po hidheshin nëpër rrugë. Dhe kishte shumë shtytje jo për kosha plehrash, por për të gjitha zgjedhjet nga Britanikët dhe nga ZKI. Nuk mbaj mend tani arsyet pse ata ishin kundër kësaj, për të bërë atë. Oh, ne nuk do ta bënim dot nëse nuk do t’i mbanin ata në veri në të njëjtën kohë. Mendoj se ky ishte argumenti. “A mund të jemi të sigurt? Nëse ne përpiqemi t’i mbajmë ata në veri dhe ata nuk punojnë?” Unë thashë, “Mirë, krijoni kushtet, nëse njerëzit nuk votojnë është zgjedhja e tyre, por ne mund t’i krijojmë kushtet”. Kështu që, ne shkuam në zgjedhje dhe ishte ndoshta dita ime më e mirë në Kosovë

kur dhjetëra mijëra serbë u shfaqën dhe votuan dhe ajo funksionoi. Dua të them që njerëzit vendosën, “Mirë, Beogradi nuk po bën asgjë për ne. Kemi disa nga drejtuesit tanë. Le t'i vendosim ata në pozicione në pushtetit dhe mbase ata mund t'i rregullojnë gjërat në komunitet. Dhe shikoni që gjërat tashmë kanë filluar të ndodhin. Tani po na i mbledhin plehrat”.

Unë mendoj se ky ishte një moment i rëndësishëm. E dija që do të shkonte mirë, por gjërat kishin ndryshuar në një mënyrë fundamentale. Në një moment unë shkova me Hashim Thaçin. Ai dëshironte të shkonte dhe të takohej në komunitetin serb, gjë që ishte një ndryshim i madh prej para nëntë vjetëve. Të ulur në dhomën e ndejës të një fermeri të varfër, një fermer serb, mendoj se kjo ishte diku në rrethin e Gjakovës, jo, ishte Lipljani, zona e Lipjanit. Ai u mirëprit në dhomën e ndenjes të një serb, rrinim, i ofroi raki. Ata të dy flisnin për çështjet e fermerëve dhe Thaçi, kur u larguam tha, “Të ia dhurojmë një traktor”.

Politikë për çështje të vogla, shumë bazike, sikur detyrat e kryetarëve të komunave që është të sigurohen që dritat punojnë, mbeturinat të mblidhen dhe shkollat të jenë të hapura. Kjo është politikë e çështjeve të vogla, ata po bënin thjeshtë politikë. Nuk kishte të bënte me përkatësinë etnike. Ishte për mënyrën sesi ju i bëni njerëzit të dalin dhe të votojnë, dhe unë mendova se kjo ishte një zhvendosje e jashtëzakonshme në dinamikën themelore midis dy grupeve etnike. Dhe pastaj zgjedhjet ndodhën dhe kishte mjaft serbë që votuan e që të kishte një rezultat legjitim. Ata i zgjodhën njerëzit dhe kjo ishte e legjitime sepse mund të ishin pjesë e qeverisë. Kanë arritur ta formojnë këshillin e tyre komunal dhe mendoj se kjo ishte një shenjë e mirë në marrëdhëniet midis dy komuniteteve dhe kishte shpresë se mund të përmirësohen ato.

Nuk e kam ndjekur fare nga afër vitet e fundit, por duket që gjërat kanë pësuar rënie nga ajo kohë. Beogradi ka arritur të riafirmojë veten, duke i nxitur përsëri të gjitha argumentet e vjetra. Dhe progresi që kemi bërë ndoshta ka rënë në masë të madhe. Kam frikë se rezultati është që komunitetet serbe përsëri janë më të izoluar sesa që ishin dhe ndoshta luftojnë më shumë për punë dhe shërbime komunale dhe për të gjitha ato gjëra që ishin siç ishin prej 2009-tës deri në '12-tën.

**Anna Di Lellio:** Cila është gjëja më e mirë që keni bërë në Kosovë sipas vlerësimit tuaj? Për Kosovën.

**Christopher Dell:** (psherëtimë e thellë) nuk e kam menduar këtë një kohë të gjatë. Ndodhën kaq shumë gjëra. E luftuam një luftë të gjatë (pauzë) e të fortë, për të mbajtur kontrollin e kufijve, veçanërisht në Veri. Kur EULEX, në një masë më të vogël NATO, KFOR-i, shumica e komuniteteve ndërkombëtare, e di, ishin të gatshëm të lejojnë që serbët t'i largojnë shqiptarët e kosovarët dhe të mos kenë prezencë në postin kufitar. Ju kujtohet se ka qenë një periudhë e bojkotimeve me kamionët?

Unë mendoj se Serbia kishte thënë që asnjë kamion nga Kosova nuk lejohet në Serbi, kështu që ata thanë që asnjë kamion nga Serbia nuk mund të hyjë në Kosovë. Dhe, kështu që qeveria e Kosovës u kundërpërgjigj në këtë mënyrë.

Dhe mbaj mend që e thirra Thaçin dhe i thashë, “Hashim, ti nuk ke kontroll mbi kufijtë e tu. A e dini se pesëqind kamionë nga Serbia hynë sot”, ose ndoshta ishin pesëdhjetë, e harrova numrin. “Çfarë?” Dhe pastaj ai u tërbua dhe ndërmoi disa veprime mjaft të nxituara për të cilat unë nuk do ta kisha këshilluar, por unë {ngre dorën dhe hap pëllëmbën} por unë nuk bëra gjë, e lash që ta ketë ai përgjegjësinë e vet. Kjo ndikoi që shumë njerëz ta humbin jetën, por në fund të fundit ajo detyroi EULEX-in ta rivendosë praninë, filluan me dërgimin e doganave kosovare dhe njerëzve të imigracionit deri në postën kufitare, duke i mbajtur ata atje, duke i mbrojtur ata. Kështu që unë mendoj, në atë pikë, se vendi ishte në prag të humbjes së kontrollit të veriut tërësisht. Kjo mund të ndodhë akoma, e dini, vite më vonë problemet nuk janë zgjidhur. Kështu që unë mendoj se kjo ishte shumë e rëndësishme. Unë e di se për çfarë doni të më pyesni.

**Anna Di Lellio:** Nuk pyeta.

**Christopher Dell:** Nuk më pyete, por e di që është në, e dini. Të gjithë duan të flasin për mënyrën sesi Atifete [Jahjaga] u bë presidente. Dhe para se të flas për këtë, dua të sqaroj diçka që ata që flasin kot në Kosovë nuk e kuptuan kurrë.

**Anna Di Lellio:** Flasin kot?

**Christopher Dell:** Po, kjo është më keq se sa një bisedë e kotë. Të gjithë njerëzit që thonë, “Oh, ju ndërkombëtarët, gjëja e vetme që ju intereson është vetëm stabiliteti. Do ta duroni Thaçin ose gjithçka tjetër në emër të stabilitetit”. Unë gjithmonë them, “Kjo është keqkuptim i objektivave tona”. Kjo është e njejtë sikur kur prindi dëshiron që fëmija i tij të jetë i suksesshëm. Qëllimi ynë këtu është qëndrueshmëria, nëse dëshironi që të keni sukses, nëse dëshironi të jeni një vend i pavarur ju duhet të jeni të qëndrueshëm. Ju duhet të keni mundësinë të krijoni vende pune, të keni një ekonomi, të drejtoni politikën tuaj dhe të gjeni rrugën tuaj në botë.

## Pjesa e Katërt

**Christopher Dell:** Ndoshta ju kujtohet një periudhë kur Kosova humbi dy presidentë brenda dy muajve. Të larguar nga detyra me vendimet e gjykatës kushtetuese, Sejdiu dhe Pacolli mbajtën

zgjedhje. Ishte jovendimtare, ashtu sikur Kosova që di të jetë jovendimtare, dhe kështu që votat u shpërndanë në tre dhe askush nuk e kishte shumicën e votave. Zgjedhjet u mbajtën, dhe kushti i Behgjet Pacollit për mbështetjen e një qeverie të koalicionit ishte se ai do të ishte presidenti. Diçka jo e mirëpritur, por është politikë demokratike, ai e kishte fuqinë në duart e tij. Ai mund ta sillte sistemin në një ndalesë të rëndë ose ai mund të bashkëpunonte. Kështu që, ai u zgjodh president. Unë mendoj se të gjithë e kanë ndier që kjo është e nevojshme. Pak kohë pas marrjes së detyrës, Gjykata Kushtetuese vendosi që zgjedhjet nuk ishin, nuk ishte në rregull dhe procedurat nuk kishin qenë të sakta. Kthim prapa në gjendje krize. Tani çfarë?

Kaluan javë të tëra ku Thaçi, Isa Mustafa dhe Pacolli po negocionin me njëri-tjetrin, duke u përpjekur të gjejnë një zgjidhje, dhe ata nuk kishin një zgjidhje. Unë i mbajta shumë takime në rezidencën time për t'ju dhënë shans që ata të bisedojnë me njëri-tjetrin dhe të përpiqen të negociojnë. Më në fund, Mustafa thotë, “Mirë Behgjet, unë do të shkoj, unë do të shkoj në LDK, do të shkoj te kryesia dhe do të kërkoj që ata të të mbështesin ty, në emër të daljes nga kjo krizë, dhe që vendi të shkoj përpara, por nuk mund të premtoj se do të kem sukses”. Sigurisht që nuk i përdori pikërisht këto fjalë. Dhe unë ju them, “Shikoni unë jam në anën tuaj dhe dëshiroj që të provoni prapë, por nëse nuk funksionon kjo ne duhet të mendojmë për alternativa. Ne kemi nevojë për një emër tjetër për të cilin të gjithë mund të pajtohem. Unë nuk kam ndonjë preferencë, kështu që mendojeni ju”.

Dhe nuk ishte çudi për gjendjen e asaj kohe. Mustafa kthehet të nesërmen dhe thotë se, “Kryesia ime nuk është pajtuar, ne nuk mund t’ju mbështesim Behgjet”. Dhe unë them mirë, ashtu si ju thashë më propozoni emra. Dhe unë mendoj se ishte në të njëjtën ditë apo mund të ketë qenë e nesërmja, por ne nuk kishim vërtetë një indikacion të qartë se kush mund të jetë [presidenti]. Por zëvendësi im tha, “E dini, Atifete Jahjagën, ajo është kompetente, është e aftë, është jopartiake, është lloji i personit që autorët e kushtetutës kishin në mendje kur krijuan zyrën e presidentit. Dikush që do ta përfaqësonte kombin dhe dikush që është mbi grindjen politike”. Dhe unë thashë, “Michael është një ide e shkëlqyer dhe unë do ta propozoj atë”.

Kështu që, të nesërmen në mëngjes, kur u takuam me të gjithë e propozova atë. Unë ju thashë, “Ok, pra, e dini që do t’ju jap një emër”. Thaçi tha, “Në rregull, por vetëm të mos jetë gazetar”. Të gjithë e dinim për kë e kishte fjalën. Dhe unë thashë, “Jo, nuk është”. Dhe më pas thashë, “Çfarë mendoni për komandanten e Forcës së Policisë Kombëtare?” Ata ishin sikur, “Kush ishte ajo?” Mirë pra, ju thashë, “Është Atifete Jahjaga. “Oh, po, mirë”. Thaçi dhe Mustafa e shikuan njëri-tjetrin dhe thanë, “Për mua nuk është problem, për ty?” “Jo, as për mua”. Behgjeti nuk e mirëpriti, por në atë moment ai nuk mund të thoshte jo, ai nuk kishte zgjedhje. Kështu që, unë e kuptoj nga vjen e gjithë legjenda e “zarfit”.

Kuptohej pse Behgjeti po sillej keq, mendohej ta delegjitime ta Atifeten që nga fillimi, sepse ishte i pakënaqur që nuk ishte president. Dhe unë e kuptoj atë, por nuk e respektoj, sepse ai nuk ka respekt për vendin dhe qëndrueshmërinë e sistemit politik të Kosovës. Pra, deri në një masë, po, ne propozuam një emër dhe aq është e vërtetë në atë legjendë, por ishin udhëheqësit e vendit që thanë, “A dini çka? Kjo është një zgjidhje e mirë. Ajo nuk është e LDK-së, ajo nuk është e PDK-së, nuk është me asnjë parti. Ajo është një person që mund të përmbushë rolin e presidentes ashtu si është dizajnuar ai rol, madje të qëndrojë mbi grindjet”. E pathënë, por në mendjet e tyre, “Ajo nuk është një kërcënim për të ardhmen e time politike”, gjë që unë e bëri atë kandidaten ideale në kuptimin që ajo ishte pa parti dhe ajo ishte lloji i presidentit që presidencës do të duhej të ishte në Kosovë. Dhe kjo ishte një mundësi e vërtetë.

Ata të gjithë ranë dakord që sistemi nuk funksiononte, me këto zgjedhje gjithnjë e më shumë të ndara se si ishin, duke shkuar në parlament, duke u përpjekur ta gjejmë një president, është dashur të mbajmë zgjedhje të drejtpërdrejta për president, por kjo natyrisht nuk i shërben vërtetë interesit të kujtdo që është në pushtet dhe i drejton këto parti. Kështu që, kur u largova, i gjithë projekti është lënë anash. Kështu që, Kosova është akoma e mbërthyer me këtë sistem, ku presidenca është vetëm një pjesë tjetër në tabelën e shahut. Një lojë e pafundme e shahut që partitë kryesore e luajnë.

**Anna Di Lellio:** Çka ju pëlqen më së shumti në Kosovë?

**Christopher Dell:** Me të vërtetë më pëlqente... Dragashi, që ishte poshtë në thellësinë e jugut. Më pëlqen shumë gryka e Rugovës, bukuria e saj. Prizreni është natyrisht i veçantë, por lidhja ime me Dragashin është personale. Vjehri im vjen nga i njëjti grup etnik si ata njerëz. Ai u lind në një vend ku sot është Serbia, por atëherë ishte Bullgaria perëndimore, dhe të folurit, dialekti i tyre është i njëjtë. Kështu që, kur shkova atje, flisja bullgarisht me njerëzit dhe ata më kuptuan. Dhe është pamje spektakulare malore. Kurrë në jetën time nuk e ka provuar kosin aq të freskët nga delet. Unë mendoj se është një pjesë magjike dhe e veçantë e vendit.

**Anna Di Lellio:** Goranët.

**Christopher Dell:** Goranët, sakt, goranët.

**Anna Di Lellio:** Dhe cili është kujtimi yt më i mirë prej Kosovës?

**Christopher Dell:** Kjo është e vështirë të thuhet sepse kam shumë. Kohë shumë emocionuese, kohë të kënaqshme, nganjëherë argëtuese. Ju e dini kur jeni diplomat është e vështirë ndonjëherë të mendoni se po bëni një ndryshim. Dua të them që diplomacia është natyrë e ngadaltë dhe e durueshme dhe

indirekte. Në një vend si Kosova, ku Amerika ka një rol të madh, ju merrni një shans për të bërë kaq shumë gjëra më mirë dhe pjesë e kësaj sidomos nëse jeni Ambasador, është t'i jepni fuqi stafit tuaj. Por kjo është, kjo është, çfarë po përshkruaj është posaqërisht e vërtetë për zyrtarë më të rinj, të cilët kalojnë vite ose duke lëshuar viza ose duke shkruar dokumente që askush nuk i lexon.

E që ata të dalin jashtë dhe të bashkëveprojnë me politikan me përvojë, të negociojnë, të ndihmojnë në procese të ecjes para, kjo ishte përvojë e shkëlqyer për ta dhe është e kënaqshme për mua si mbikëqyrës sepse me të vërtetë ke bërë diçka për t'i ndihmuar ata të mësojnë dhe ta nxisim ngritjen e tyre profesionale. Nuk e di, me të vërtetë nuk di ku të bëj me gisht, do të më duhet të mendoj më gjatë se që ti do të dëshiroje të zgjaste inçizimi për të kujtuar cila ishte përvoja ime absolutisht më e mira.

Unë tashmë përmenda disa nga gjërat që ishin shumë të kënaqshme, ju e dini, duke parë që serbët mund të kthehen në proces, poqëse ti, poqëse do të trajtoje këtë politikë të pakicës, e jo politikë etnike. Ruajtja e sistemit nga paraliza ishte shumë e rëndësishme për mua.

**Anna Di Lellio:** Po pyesja për diçka më personale.

**Christopher Dell:** Po.

**Anna Di Lellio:** Nëse ke ndonjë kujtim?

**Christopher Dell:** Unë e di dhe po mendoj, ka aq shumë, të gjitha këto gjëra janë personale, edhe ato profesionale, ju e dini (pauzon). Nuk dua t'ju tregoj për këtë. Thjesht tingëllon si egoizëm. E dini, unë mendoj se lloji i kujtesës vizuale është më i miri për mua, pra janë... dy gjëra. Më kujtohet kur shkoja, cili është emri i kalimit ndërmjet, gjatë rrugës për në Prizren, nëse kalon nëpër male në jug?

**Anna Di Lellio:** Gorina.

**Christopher Dell:** Pika e lartë, kalimi, është ngritur një hotel atje.

**Anna Di Lellio:** Oh, në Prizren, malet e Sharrit.

**Christopher Dell:** Po, malet e Sharrit.

**Anna Di Lellio:** Malet e Sharrit.

**Christopher Dell:** Aty ku e arrin kulmin dhe e shihni se si shkon poshtë në drejtim të Prizrenit. Aty është ky mal, dua të them shumë i bukur, edhe muzgu. Mbaj mend që qëndroja atje në veri, në veri të Pejës, afër kufirit serb atje, është një fshat në pikën e lartë dhe mund të shihni pothuajse të gjithë



vendin. Do të thotë që mund t'i shihni Malet e Sharrit poshtë në jug. Mund t'i shihni Bjeshkët e Nemuna në perëndim. Kjo është pak dramatike, por prej aty mund ta shihni pothuajse gjithë shtrirjen e Kosovës.

Kam një kujtim të dashur kur erdhi Eliza Dushku. Fadil Berisha më telefonoi në orën dhjetë të natës dhe më ka thënë, “Çfarë po bën?” Unë thashë, “Po bëhem gati për gjum”. “Epo, ja unë jam këtu me Eliza Dushku” dhe {pëshpërit} nuk e dija kush ishte ajo, por nejse. “Pse nuk po vjen dhe takohu mene pak?” Kështu që, më vonë shkuam në një klub nate me të dhe me bashkëshortin e saj, të dashurin në atë kohë, që ishte një ish-roje i LA Lakers, njeri i mirë. Dhe shkuam në klub nate dhe shqiptarët ishin shumë të entuziazmuar sepse e njihnin të gjithë, madje më mirë se unë. Shumë emocionuese, kaq shumë energji në dhomë. Të gjithë ata të rinj, dhe gjithë ajo lumturi. Pra, një shqiptare e famshme, që kishte arritur diçka në botë, është kthyer në vendin e vet. Kjo ishte para, e di, nuk mund t’ia kujtoj emrin. Po mundohem të tinglloj kulturalisht hip, por nuk po ia arrij dot.

**Anna Di Lellio:** Rita Ora.

**Christopher Dell:** Diya, Diya, Lia Dupa. Po, sakt. Rita Ora, Dua Lipa me të vërtetë kanë pasur sukses. Ajo ishte një nga emrat e mëdhenj shqiptarë në perëndim. Ky ishte një kujtim shumë argëtues. Unë e mbështeta këtë ide, dhe unë morra para nga Departamenti i Shtetit për ta bërë atë, këtë film në lidhje me pajtimin etnik në Kosovë. Është quajtur “*The Wall*” [Muri] ose “*The Walls*” [Muret]. Ishte menduar të prodhohet si një serial, i krijuar për t’i bërë njerëzit të flasin mbi dialogun. Është “Romeo dhe Zhuljeta” e vendosur në Kosovë, ku një djalë shqiptar bie në dashuri me një vajzë serbe, familjet e të cilëve i ndau lufta, ishte ky lloj tregimi. Realizimi dhe transmetimi i këtij seriali ishte një moment personal i kënaqshëm, sepse unë isha i përfshirë thellë në projekt. Fatkeqësisht, mendoj se është transmetuar gjatë Kampionatit Evropian të Futbollit, kështu që kurrë nuk mori aq shumë vëmendje. Mendova se ishte realizuar mirë, ashtu siç e meritonte, por nuk e di, nuk e di. Pra ka aq shumë kujtime të mira. Nuk ishte turneu im i preferuar prej nëntë apo dhjetë që i kam bërë në Shërbimin e Jashtëm. Sigurisht, ishte më i kënaqshmi.

**Anna Di Lellio:** Tani po vijmë te pjesa kur ju e keni përfunduar misionin në Kosovë, keni bërë diçka plotësisht ndryshe, apo?

**Christopher Dell:** Kur u largova nga Kosova, vazhdova me një detyrë tjetër të Shërbimit të Jashtëm, vazhdova të isha Zëvendës Komandanti i Komandës SHBA-ve në Afrikë, i cili ishte i vendosur në Shtutgard. Tani, kjo është pjesë e legjndës anti-Dell, e dini, që “Bechtel” ndërtoi autostradën dhe Dell kishte marrë ryshfet nga “Bechtel”, duke shkuar për të punuar për ta. Kjo pasqyron, si ta them,

inJORANCËN e thellë të vendit tim dhe mënyrën se si funksionojnë Shtetet e Bashkuara. Është e vërtetë që, e dini, faktet janë fakte, “Bechtel” ndërtoi një autostradë në Kosovë dhe aprovimi i kësaj u dha kur isha une ambasador atje. Ne kemi avokuar në emër të tyre, por kjo kërkon një vendim zyrtar nga Departamenti i Tregtisë i SHBA-ve për të avokuar. Nuk ka asnjë lidhje me rolin tim ose kontributin tim në këtë, dua të them që, kishte vetëm një kompani amerikane që garonte, dhe natyrisht përfundimisht...

Çfarë unë... dhe “Bechtel” fitoi atë konkurs jo për shkak rolit tim, por sepse Hashim Thaçi kishte parë punën që e kishte bërë “Bechtel” në Shqipëri dhe në Kroaci, dhe ai e dëshironte të njejtën cilësi të infrastrukturës për vendin e tij. Por, e dini, nuk mund ta fajësoni atë për këtë gjë. Ai pa se çka është mirë dhe ia donte të mirën Kosovës. Por natyrisht, çdo projekt i asaj shkalle në një vend si Kosova ku thashethemet janë aktivitetet e lirë kombëtar, dhe duhej të ekzistonte një shpjegim tjetër. Fakti që “Bechtel” kishte të ulët, ofertën më të ulët, nuk ishte e mjaftueshme që ata e fituan kontratën. Po sipas tyre duhet të ketë diçka më shumë, dhe natyrisht, kush është personi më i rëndësishëm në vend? Ambasadori Amerikan, “Eh, po, me siguri ai ka bërë që kjo të ndodh”. Në fakt, unë nuk kam pse të bëj diçka.

Madje, as sot nuk e di çfarë vlere mban ajo kontratë, sepse ata kurrë nuk ma treguan kontratën. Pieter Feith ishte zemëruar që nuk ia dhash kontratën që ai ta lexonte. Epo, në fakt është kundër ligjit Amerikan që të shpërndahen informacione të korporatave. Hashim Thaçi më ka thënë që Feith kishte marrë para nga konkurrenti austriak “Strabag”, për të avokuar në emër të tyre. “Hashim, nuk është e vërtetë”. Kam qenë naiv, mendoj. “Hashim, kjo nuk është e vërtetë. Ai është përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, është një kompani evropiane, ai po avokon për ta njejtë sikur amerikanët avokojnë për kompanitë amerikane. Është çfarë bëjnë diplomatët. Është tregti”.

Më pas e kuptova që jam treguar naiv. Dhe mendoj që kjo ka ushqyer tregimin i cili tregohet nga ato ditë. “Strabag” me të vërtetë po shpërndante para në tërë Kosovën duke u përpjekur të fitonte kontratën. Dhe puna ime nuk ishte për ta bindur Hashimin ta përzgjidhte një kompani amerikane. Detyra ime ishte t’i mbaja të gjithë njerëzit të cilët po përpiqeshin të merrnin një pjesë të aksionit larg nga paratë. Dhe kishte shumë në Ministrinë e Transportit dhe gjetiu nëpër Kosovë, të cilët me përpiqeshin të fitonin para nga kjo marrëveshje, duke përfshirë të gjithë njerëzit që kishin blerë tokë përgjatë rrugës origjinale, tunelin përmes maleve. Dhe “Bechtel” propozoi që të ndërtohet rreth maleve me qëllim që t’i shpëtoj pesëqind milion dollarë, investimi i tyre papritmas nuk vlente aq shumë.

Ajo që ndodhi gjatë kësaj ishte se menaxheri i vjetër në “Bechtel”, disa prej tyre thanë, “Prisni një minut, ata sapo zbuluan gaz natyror në Mozambik. Është një vend për të cilin nuk dimë asgjë. Ne njohim dikë që di diçka për Mozambikun. Dhe ne nuk do të shkojmë verbërisht në një vend si Mozambiku pa ditur çfarë po ndodh atje dhe pa e njohur politikën. Ne duhet ta kuptojmë më shumë para se të rrezikojmë”. Kështu që ata erdhën tek unë rreth një javë para se të largohesha nga vendi, para se të largohesha nga Kosova dhe më pyetën nëse do konsideroja ndonjëherë të punoja për një kompani si “Bechtel”. Dhe ju thashë, “Mirë, sigurisht, ejani prapë, më jepni një përshkrim pune, ma bëni një ofertë”. Dhe nuk ndodhi asgjë për një vit. Po mendoj, asnjëherë nuk e kam kuptuar pse nuk ndodhi më shpejt, çfarë po ndodhte. Por sidoqoftë, u largova në Gjermani për një vit dhe kalova vitin e fundit në Shërbimin e Jashtëm duke punuar përsëri në çështjet afrikane, gjë që natyrisht, ishte e rëndësishme sepse unë ende dija gjëra për Afrikën, dhe tani dija më shumë për Afrikën kur fillova, dhe unë mendoj se kisha diçka për t’i ofruar “Bechtel” në atë pikë në lidhje me përvojën time mbi Afrikën.

Por ideja, natyrisht, që është promovuar nga Pieter në shkrimin e tij dhe të tjerët, që urryesit do të urrejnë në Kosovë. Dua të them që kjo ishte një *quid pro quo* [favor për favor], “Unë ju siguroj autostradën. Ju ma siguroni një punë”. Unë e di çfarë mendojnë ata dhe nuk mund ta kundërshtosh një negativ. Por kjo zbulon një keqkuptim të thellë se si funksionon qeveria amerikane, rreth asaj se sa seriozisht ndërmarrjet amerikane e marrin Aktin e Praktikave të Korruptuara të Jashtme, i cili mund ta shkatërroj një kompani, po mendoj mund të jetë rrënuese, dhe përfundimisht, edhe për pozitën e Kosovës në botë. Kontrata në Kosovë, cila do që ka qenë, nuk e di, përfundimisht një miliard dollarë, e shpërndarë gjatë katër viteve, për një kompani si “Bechtel” janë para të vogla, dhe nuk ia vlen të rrezikosh kompaninë, nuk ia vlen të rrezikosh të shkosh në burg në bazë të Ligjit të Praktikave të Korruptuara të Jashtme për tëa bërë një marrëveshje vetëm për ta ndërtuar një autostradë në Kosovë. Dua të them që “Bechtel” ka të ardhura dyzet miliardë dollarë në vit. Nuk është e nevojshme të, e dini, të merren me praktika të dyshimta për të fituar një tender të vogël autostrade në një vend si Kosova.

Asgjë që them nuk do t’i bindë ata njerëz. Unë e di që mund të tingëlloj sikur po justifikohem, por kurrë nuk jam shqetësuar për këtë sepse, e dini, unë e di se çfarë ka ndodhur dhe ndërgjegja ime është e pastër. Dhe, ju e dini, kushdo që dëshiron të shkojë të flasë me avokatët “Bechtel” mund të shikojë hetimin për gjithçka që ata bënë, vetëm për të qenë të sigurt se gjithçka ishte në rregull.

**Anna Di Lellio:** Pra prej Shtutgardit prapë në Mozambik?

**Christopher Dell:** U ktheva në Mozambik për të punuar për “Bechtel” si menaxher i vendit të tyre.

**Anna Di Lellio:** Ende je në shërbimin e jashtëm?

**Christopher Dell:** Kështu që, unë u largova, u tërhoqa nga Departamenti i Shtetit. Dhe një nga gjërat që ju duhet të bëni, minutën që ata erdhën tek unë dhe më pyetën nëse do të mendoja ndonjëherë të punoja për ta, është dashur të shkëputem nga çdo angazhim tjetër me “Bechtel”, pra në, e dini, në cilësinë e zyrtarit qeveritar. Dhe këtë e bëra, e dini, zyrtarisht e thua, “Ata më janë qasur, ata më kanë ofruar një punë, andaj unë po tërhiqem, dhe ia delegova punët zëvendësit tim”, ashtu siç bëri Jeff Sessions gjatë Hetimit Rus, apo jo. Unë nuk mund të jem i përfshirë më në këtë, sepse unë, sepse kam interesa të tjera. E dini, dua të them që e kam braktisur brenda një javë ose dy sidoqoftë, andaj asgjë nuk u përmend. Në atë pikë autostrada ishte në ndërtim e sipër. Nuk kishte aspak rëndësi, por...

**Anna Di Lellio:** Dhe prej Mozambikut je kthyer këtu?

**Christopher Dell:** Dhe prej Mozambikut jam kthyer këtu.

**Anna Di Lellio:** Pra nuk je pensionuar?

**Christopher Dell:** Jo, jo tërësisht, jam duke i bërë disa gjëra me kohë të pjesshme. Unë punoj me një bankë të vogël investimesh që investon në projekte energjetike në Afrikë, i përfaqësoj ata këtu në Washington. Por gjëja që më duket më interesante është se jam duke shkruar një tregim, ajo që kam ndërmend të bëj është një tregim rreth navigimit Portugez, nga Epoka e Zbulimit. Më pëlqen të shkoj atje. Unë e dua Portugalinë, dua të shkoj atje. Më pëlqen historia, dhe është nën radar, është një aspekt pak i njohur në histori, ku roli Portugez ishte jashtëzakonisht i madh në krahasim me vendin dhe ndikimin, ky rol u harrua kryesisht në botën jo-portugeze. Dhe kështu që, dua ta shkruaj një histori popullor për të shitur disa kopje dhe për të sjell disa nga ato histori përsëri në dritën e ditës.

**Anna Di Lellio:** Interesante. Në rregull, a dëshiron të shtosh diçka?

**Christopher Dell:** Jo, mirë është.

**Anna Di Lellio:** Të faleminderit shumë!

**Christopher Dell:** Falemnderit, Anna!